Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2021

Shkup, 2022

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE....5

PJESA 1....6

1.1. Hyrje....6
1.2. Historia e AZGJ-së....7
1.3. Misioni dhe vizioni....8

PJESA 2....9

2.1. Statusi....9
2.2. Udhëheqja....9
2.3. Kompetencat ligjore të AZGJ-së....9
2.4. Parimet dhe vlerat e punës....10

PJESA 3....11

3.1. Vendosja organizative....11
3.2. Burimet njerëzore....14
3.3. Struktura e të punësuarve....16

PJESA 4....19

4.1. Pasqyra e punës....19
4.2. Përkthimi dhe lekturimi në AZGJ....20
4.3. Pyetësorët anketues....21
4.4. Regjistrat (baza e të dhënave)....26
4.5. Trajnimi për përkthyesit dhe për lektorët e sektorit publik....28
4.6. Trajnimet për të punësuarit në AZGJ....28
4.7. Parashtresat nga personat fizikë dhe juridikë....29

4.8. Informimi....30
4.9. Buletini mujor....30
4.10. Ueb-faqja zyrtare dhe mediet digjitale... 31
4.11. Fjalori elektronik VERBIS....33
4.12. Botimet e shtypura dhe ato elektronike 34
4.13. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimi 35
4.14. Pasqyra e akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut 38

PJESA 5....42

5.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi....42
5.2. Furnizimet publike....43

PJESA 6....45

6.1. Pasqyra e aktiviteteve të realizuara....45

REKOMANDIME 165

FJALA HYRËSE



Para jush është Raporti i Tretë Vjetor i Punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AZGJ) gjatë vitit 2021, që paraqet një pasqyrë dhe kornizë gjithëpërfshirëse të aktiviteteve të realizuara të AZGJ-së në përpjekjet e saj për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimin e kapaciteteve profesionale të institucioneve për përkthim dhe për lekturim, si dhe mbështetjen e tyre, në nivel qendror dhe lokal, për të mundësuar realizimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve.

Edhe krahas efekteve të vazhduara të pandemisë globale, të shkaktuar nga virusi korona SARS CoV-2 (Covid-19) dhe kufizimeve të lidhura me realizimin e takimeve të drejtpërdrejta, ngjarjeve dhe anulimit të takimeve të dakorduara në vend dhe jashtë tij, përsëri AZGJ-ja edhe në vitin 2021 arriti me një intensitet të pazvogëluar të realizojë një sërë aktivitetesh në aspektin e ushtrimit të kompetencave të veta ligjore. Krahas faktit që Republika e Maqedonisë së Veriut ka legjislaturë të avancuar, me të cilën rregullohet përdorimi i gjuhëve në sektorin publik, prapëseprapë, gjatë zbatimit të saj, shfaqen vështirësi dhe sfida, që tregon se ka nevojë për angazhim të vazhdueshëm me përpjekje dhe punë të përbashkët deri në arritjen e qëllimeve të caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, e ato janë promovimi, mbrojtja dhe zbatimi i njësuar i gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe).

Në vazhdim mund ta lexoni raportin, ku është dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, me rekomandimet përfundimtare për zbatimin më efikas dhe më efektiv të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. AZGJ-ja do të vazhdojë me realizimin e aktiviteteve të saj edhe në vitin 2022, për arsye se angazhimi ynë është që të realizohen të drejtat gjuhësore të qytetarëve dhe, besojmë se, bashkërisht do ta arrijmë qëllimin drejt ndërtimit të shoqërisë së qytetarëve të barabartë.

Me respekt,

prof. dr. Ylber Sela,
drejtor

PJESA 1

1.1. Hyrje

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut[1] (në tekstin e mëtutjeshëm: AZGJ) është themeluar në pajtim me ligjin, në cilësinë e personit juridik, e që është kompetente për standardizimin dhe njësimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Raporti Vjetor i Punës ka të bëjë me periudhën 1.1.2021 deri më 31.12.2021 dhe është përgatitur në bazë të nenit 18, paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 7/2019), sipas të cilit AZGJ-ja për punën e saj dorëzon raport në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, së paku një herë në vit, deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Raporti përmban rishikimin e aktiviteteve të AZGJ-së në zbatimin e kompetencave të saj ligjore, me qëllim që të realizohen të drejtat gjuhësore të gjuhëve zyrtare, zbatimi i vazhdueshëm i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, përforcimi i kapaciteteve përkthyese të institucioneve etj. AZGJ-ja në punën e saj ishte e vendosur në qëllimin aktiv, që të veprojë në shërbim të demokracisë dhe sundimit të së drejtës nëpërmjet promovimit të të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përkundër të gjitha përpjekjeve, raportet tona nga terreni, parashtresat e qytetarëve, raportet e medieve dhe të organizatave joqeveritare, tregojnë se shumë qytetarë akoma përballen me vështirësi në realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me ligj në komunikimin e përditshëm me institucionet. Kjo tregon se ka nevojë që të gjitha institucionet të japin shumë mund për t'i arritur qëllimet e caktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Të udhëhequr nga qëllimi për t'u zgjidhur problemet institucionale lidhur me numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve në institucione dhe cilësinë e dobët të përkthimeve dhe lekturimeve nëpër dokumentet zyrtare, AZGJ-ja ndërmori aktivitete për të realizuar trajnime për përkthim dhe për lekturim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive profesionale dhe të njësimit të procesit të përkthimit dhe të lekturimit të gjuhëve zyrtare për të punësuarit, gjegjësisht personat e angazhuar që kryejnë përkthim dhe lekturim të gjuhëve zyrtare në institucionet e sektorit publik.

[1] Forma e shkurtër e emrit zyrtar: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

1.2. Historia e AZGJ-së

Më 6 shkurt 2019 u shpall konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të AZGJ-së, që zgjati në pajtim me datën 13 shkurt 2019, ku me Aktvendimin e zgjedhjes, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen mbajtur më 25 shkurt 2019, u zgjodh prof. dr. Ylber Sela si drejtor i AZGJ-së.

Më 11 mars 2019 u dorëzua fletëparaqitje për regjistrimin e themelimit të AZGJ-së në Regjistrin Qendror, ku aktvendimi për regjistrimin e themelimit u miratua më 13 mars 2019. Data formale e themelimit të AZGJ-së është 14 janar 2019, respektivisht dita e hyrjes në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.7/2019). Nga themelimi i saj, selia formale e AZGJ-së ishte në bul. "Ilindeni" nr.2/ ndërtesa 6 – zyra 410.

Në mbledhjen e 162-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 5 nëntor 2019, Qeveria e miratoi Vendimin nr. 45-8714/1, për dhënie në shfrytëzim të përhershëm të sendeve të patundshme të AZGJ-së ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 236/2019), që ishte bazë për t'u kryer regjistrimi për ndryshimin e selisë së AZGJ-së, ku me Aktvendim të Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120190016864 të datës 21.11.2019, u bë ndryshimi i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresë të re: Shëtitorja "Dimitar Vllahov" nr.4, kati 4, Qendër, Shkup, gjithashtu është regjistruar edhe shkurtesa e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe është bërë Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV.

Në seancën e 45-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 16 shkurt 2021, Qeveria miratoi Vendimin nr. 40-2389/1 për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të gjësendeve të patundshme AZGJ-së (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 43/2021), i cili ishte bazë për regjistrimin e ndryshimit të selisë së AZGJ-së, ndërkaq me Aktvendimin e Regjistrit Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30120210008095, datë 3.3.2021, është bërë ndryshimi i regjistrimit të selisë së AZGJ-së në adresën e re: rr. "Filipi i Dytë i Maqedonisë" nr. 11, kati i 3-të, Shkup.

1.3. Misioni dhe vizioni

AZGJ-ja ka mision të krijojë mjedis institucional që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, që e promovon, që e ruan dhe që e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo përfshin aktivitete lidhur me ndihmesën praktike dhe përkrahjen këshillëdhënëse në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nga ana e institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, agjencive, drejtorive, institucioneve dhe organizatave, komisioneve, personave juridikë që kryejnë autorizime publike, si dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale; kujdes i vazhdueshëm për zbatim të rregullt dhe të qëndrueshëm të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqipe), si dhe avancimin e përdorimit zyrtar të gjuhës, si e drejtë themelore e qytetarëve.

Vizioni i AZGJ-së është të mundësojë barazi gjuhësore të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të rregullores ligjore për përdorimin e gjuhëve. Duke nxitur cilësi të lartë të proceseve të punës, efektivitet të vazhdueshëm dhe efikasitet në punë, të plotësuar me kuadër profesional dhe kapacitete teknike, si dhe të hapur plotësisht për bashkëpunim me publikun, me sektorin akademik dhe me atë qytetar, AZGJ-ja synon të bëhet e njohur si institucion me rëndësi strategjike në procesin e mbrojtjes, avancimit, standardizimit dhe përdorimin e njësuar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA 2

2.1. Statusi

AZGJ-ja ka cilësinë e personit juridik me të drejta, me detyrime dhe me përgjegjësi të përcaktuara në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Më 14.1.2019 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 7/2019 u shpall dhe hyri në fuqi Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, me çka AZGJ-ja u themelua në cilësinë e personit juridik, me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të caktuara me të njëjtin ligj.

2.2. Udhëheqja

AZGJ-në e udhëheq drejtori i zgjedhur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar, me të drejtë për t'u rizgjedhur. Për punën e tij dhe për atë të AZGJ-së, drejtori i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.3. Kompetencat ligjore të AZGJ-së

Në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, AZGJ-ja është kompetente për kryerjen e punëve në vijim:

- mbështetjen e institucioneve për realizimin e detyrimeve të këtij ligji, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- lekturimin e të gjithë akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut";
- promovimin dhe marrjen e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- përgatitjen e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zbatimin e kompetencave të saj;
- përgatitjen e materialeve profesionale-analitike nga kompetencat e saj për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- dhënien e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut; dhe

- punë të tjera që lidhen me zbatimin e qëllimeve të vërtetuara me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Krahas kompetencave të saj ligjore, AZGJ-ja kujdeset për sigurimin e vazhdueshëm të funksionalitetit dhe forcimin e kapaciteteve të veta, si dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm që i respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, që e mbron, e promovon, e ruan dhe e përforcon të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.4. Parimet dhe vlerat e punës

- ligjshmëria;
- profesionalizmi dhe kompetenca;
- përfaqësimi i duhur dhe i drejtë;
- shërbimet e orientuara;
- etika profesionale, paanshmëria dhe objektiviteti;
- transparenca dhe besueshmëria;
- përgjegjësia;
- parandalimi i konflikteve të interesit;
- të qenit ekonomik; dhe
- respektimi i standardeve për udhëheqje me cilësi.

PJESA 3

3.1. Vendosja organizative

Duke u nisur nga kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Nëpunësve Administrativë, si dhe nga Dekreti për Parimet e Organizimit të Brendshëm të Organeve të Administratës Shtetërore, e me qëllim të bashkimit të disa funksioneve të ndërlidhura ndërmjet tyre, organizimin, ndjekjen dhe koordinimin me burimet njerëzore, punën profesionalo-analitike, administrative, informativo-komunikuese, operative, materiale, financiare, informatiko-teknologjike, profesionalo-administrative dhe punë të tjera, në pajtim me Rregulloren për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, AZGJ-ja është e organizuar në 4 (katër) sektorë me 9 (nëntë) njësi në përbërje të tyre dhe 2 (dy) njësi të pavarura, siç vijon:

(1) Sektori i mbështetjes së drejtorit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Njësia e mbështetjes së drejtorit; dhe
- Njësia e marrëdhënieve me publikun.

(2) Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e avancimit të zbatimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve;
- Njësia e teknologjisë informatike; dhe

(3) Sektori i përkthimit dhe i lekturës, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e përkthimit; dhe
- Njësia e lekturës.

(4) Sektori i çështjeve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore, me njësitë në vazhdim:

- Njësia e çështjeve të përgjithshme dhe juridike; dhe


- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Njësitë e pavarura janë:

(1) Njësia e çështjeve financiare; dhe

(2) Njësia e revizionit të brendshëm.

ORGANIGRAMI I AZGJ-së



Organigrami i AZGJ-së

3.2. Burimet njerëzore

Në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, janë paraparë 78 vende të punës. Nga numri i përgjithshëm i vendeve të parapara të punës, 75 vende pune janë me statusin e nëpunësit administrativ, kurse tri vende janë me statusin e personave ndihmës-teknikë.

Në AZGJ me gjendjen e datës 31.12.2021 janë punësuar gjithsej 18 persona, që kanë statusin e nëpunësve administrativë, prej të cilëve një personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës për shkak të emërimit në funksion tjetër publik, ndërkaq në mënyrë plotësuese edhe një person tjetër me procedurë lëvizshmërie është transferuar nga një organ tjetër. Gjatë vitit 2021 në pajtim me Raportin vjetor të punësimeve për vitin 2021, AZGJ-ja ka bërë shpallje publike për punësim të 15 nëpunësve administrativë, që e realizoi plotësisht.

Në pajtim me datën 31.12.2021, përqindja e plotësimit të vendeve të punës sipas realizuesve, arrin 44,87% nga numri i përgjithshëm i sistematizimit sipas realizuesve.

Plotësimi i vendeve të punës në AZGJ i shprehur në numra, sipas njësive organizative, në pajtim me datën 31.12.2021 është siç vijon:

- këshilltarë shtetërorë – 2
- Sektori i mbështetjes së drejtorit – 7
- Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit – 6
- Sektori i përkthimit dhe i lekturës – 11
- Sektori i çështjeve të përgjithshme, juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore – 7
- Njësia e çështjeve financiare - 2
- Njësia e revizionit të brendshëm – 0

Në Njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore, në bazë të Programit vjetor për trajnime gjenerike të nëpunësve administrativë, të miratuar nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, po përgatitet Plani vjetor për trajnime të nëpunësve administrative, sipas mendimit të marrë nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës.

Tabela 1. Pasqyra e vendeve të punës të sistemuara dhe të plotësuara në AZGJ

Njësitë organizative	Vendet e sistemuara të punës Gjendja më 31.12.2021	Numri i plotësuar i realizuesve Gjendja më 31.12.2021
Këshilltarë shtetërorë	3	2 (1 person përkohësisht është marrë nga një organ tjetër)
Sektori i mbështetjes së drejtorit	16	7 (1 personit i është lënë pezull marrëdhënia e punës)
Sektori i planifikimit, i koordinimit dhe i zhvillimit	11	6
Sektori i përkthimit dhe i lekturës	26	11
Sektori i çështjeve juridike, të përgjithshme dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore	15	7
Njësia e çështjeve financiare	5	2
Njësia e revizionit të brendshëm	2	0

3.3. Struktura e të punësuarve


Plotësimi sipas kategorive të vendeve të punës të nëpunësve administrativë

- nëpunës udhëheqës administrativë – 12;
- nëpunës profesional administrativë – 23;
- nëpunës ndihmës-profesionalë administrativë – 0;
- persona ndihmës-teknikë – 0.

Plotësimi sipas shkallës së arsimit:

- me arsim të lartë – 35;
- me shkollë të mesme – 0;
- me shkollë fillore – 0.

Grafiku 1. Numri i të punësuarve sipas shkallës së arsimit



Plotësimi sipas strukturës gjinore:

- gjinia femërore – 20
- gjinia mashkullore – 15

Grafiku 2. Struktura gjinore e të punësuarve





Tabela 2. Struktura e të punësuarve në AZGJ në pajtim me 31.12.2021

Kategoritë e vendeve të punës	Gjinia		Shkalla e arsimit		
	M	F	PLP	PMP	Fillore
Udhëheqëse	6	6	12	0	0
Profesionale	9	14	23	0	0
Ndihmëse-profesionale	0	0	0	0	0
Ndihmëse-teknike	0	0	0	0	0
Gjithsej	15	20	35	0	0

Grafiku 3. Struktura e të punësuarve në AZGJ në pajtim me 31.12.2021



4.1. Pasqyra e punës

AZGJ gjithmonë synon të sigurojë kryerjen e sigurt dhe efektive të detyrimeve ligjore që janë kyç, por edhe të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme përforcimin e kapaciteteve të veta.

Prioritetet kryesore dhe qëllimet zhvillimore të AZGJ-së rrjedhin nga kompetencat e saj ligjore dhe fokusohen në zbatimin e plotë dhe të qëndrueshëm të rregullores ligjore për zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve, por edhe në rindërtimin dhe përforcimin e saj në aspektin e kapaciteteve për kryerjen e funksioneve të saj. Në këtë kontekst, AZGJ-ja para vetes ka vendosur shumë qëllime strategjike afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të realizohen, siç vijon:

- përcjellje e vazhdueshme e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve;
- analizë të përvojave më të mira botërore dhe modeleve të shumëgjuhësisë;
- promovim dhe zhvillim të sistemit për zbatim aktiv të gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- avancim të funksionimit dhe realizimit të kompetencave të AZGJ-së nëpërmjet sigurimit të përkrahjes administrative, logjistike dhe teknike;
- përforcim të kapaciteteve me burime njerëzore nëpërmjet punësimeve të reja, shpërndarjeve dhe avancimeve, në bazë të parimeve të profesionalizmit dhe kompetencës dhe me zbatimin e parimeve të përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive, si dhe nëpërmjet përsosjes profesionale të të punësuarve në AZGJ;
- përforcim të punës financiare dhe materiale, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit strategjik në AZGJ, e plotësuar me aktivitete për themelimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e udhëheqjes financiare dhe kontrollit;
- përmirësim të punës së AZGJ-së, nëpërmjet rritjes së efektshmërisë së sistemeve për kontroll të brendshëm dhe pajtim të punës me ligjet, me aktet nënligjore dhe me aktet e brendshme;

- themelim të programeve për të punësuarit në AZGJ për zhvillim sistemor të shkathtësive të tyre, njohurive dhe sjelljes, të nevojshme këto për realizimin e qëllimeve afatmesme dhe afatgjata;
- themelim dhe avancim të bashkëpunimit me palët përkatëse të interesuara, duke përfshirë edhe organet shtetërore, dhomat ekonomike, sektorin joqeveritar, bashkësinë e donatorëve, korin diplomatik, organizatat ndërkombëtare.


4.2. Përkthim dhe lekturim në AZGJ

Gjatë vitit 2021, në AZGJ janë dorëzuar 90 kërkesa për përkthim dhe 381 kërkesa për lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare.

Tabela 3. Pasqyra e kërkesave për përkthim dhe për lekturim

Përkthim me lekturim	% e përkthimeve të realizuara	Vetëm lekturim	% e kërkesave të realizuara për lekturim
90	100%	381	100%


Grafiku 4. Kërkesat e arritura sipas llojit dhe numrit





4.3. Pyetësorët anketues

AZGJ-ja gjatë vitit 2021 dorëzoi gjithsej 410 pyetësorë anketues, me një paketë pyetjesh të strukturuara, tek institucionet e nivelit qendror dhe atij lokal, ku përgjigje kthyese mori në gjithsej 127 pyetësorë anketues, gjegjësisht 30,98% nga pyetësorët e dorëzuar anketues.


Në vijim është dhënë një pasqyrë tabelore e rezultateve të marra në lidhje me çdo pyetje të pyetësorit anketues.





2. Nëse nuk keni filluar zbatimin, a keni nevojë për ndihmë profesionale nga Agjencia?
119
99
79
59
39
19
-1
19
42
28
20
Po
Jo
S'ka përgjigje
Do të kërkojnë ndihmë nëse ju duhet


3. Në aktin tuaj të sistematizimit të vendeve të punës, a keni paraparë formë organizative për përkthim dhe lekturë në dhe prej gjuhës shqipe? Dhe, nëse nuk keni paraparë, cila është arsyeja?
119
99
79
59
39
19
-1
37
72
Po
Jo


4. Sa përkthyes dhe sa lektorë keni në institucionin tuaj dhe, në qoftë se nuk keni, përse?




5. Sa përkthyes dhe sa lektorë ju nevojiten që institucioni juaj të funksionojë me sukses në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve?




6. Vallë, në buxhetin e parashikuar për vitin 2022, a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe për lektorë të rinj?



7. Në cilin mënyrë mund t'ju ndihmohet për përshpejtimin dhe zbatimin e tërësishëm të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve?





4.4. Regjistri (baza e të dhënave)

AZGJ-ja përgatiti regjistër të personave me status të nëpunësve administrativë, persona të angazhuar në bazë tjetër apo bashkëpunëtorë të jashtëm, të cilëve u janë dhënë detyra pune për përkthim dhe lekturim, nga gjuha maqedonase në atë shqipe dhe anasjelltas. Ky regjistër do t'i shërbejë AZGJ-së, që të krijojë një pasqyrë të plotë të gjendjes me kuadrin e përkthyesve dhe të lektorëve në organet e pushtetit qendror, me qëllim që në të ardhmen edhe ata të mund të përfshihen nëpër programet dhe trajnimet për përkthyes dhe lektorë, që i organizon AZGJ-ja.


4.5. Trajnimi për përkthyesit dhe për lektorët e sektorit publik

Gjatë vitit 2021, AZGJ-ja realizoi trajnim dymujor për 65 përkthyes dhe lektorë nga 31 institucione publike, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e kapaciteteve profesionale për përkthim dhe për lekturim, si dhe njësimin e terminologjisë administrative, në bashkëpunim me gjuhëtarë dhe ekspertë të njohur të gjuhës. Trajnimi filloi më 6 maj dhe zgjati deri më 7 korrik, ku morën pjesë 15 ligjërues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës.




Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësi të trajtojnë një sërë çështjesh që shfaqen nga përdorimi i gjuhës shqipe në administratën publike. Problemi i terminologjisë dhe njësimi i saj si nevojë, ndikimet e gjuhëve, leksikografia, semantika, ndikimet sintaksore e një sërë problemesh të tjera, ishin objekt shtjellimi nga profesorët Emil Lafe, Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Valter Memisha, Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Berton Sulejmani, Ajten Hajdari-Qamili, Xhelal Zejneli, Afet Mamuti, Qemal Murati, Izer Maksuti, Zeqirija Ibrahimi, Adnan Jashari dhe Mustafa Ibrahimi.

Me mbështetjen financiare dhe teknike të Misionit të OSBE-së në Shkup, është përgatitur *Manuali për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve* në tri gjuhë, i cili iu shpërnda secilit pjesëmarrës në trajnim.







Më 30 korrik 2021, AZGJ-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Sistemit Politik dhe të Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, organizuan një ceremoni përmbyllëse në të cilën u dorëzuan certifikatat për të gjithë pjesëmarrësit në trajnim. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të shënimit të 20 vjetorit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.







4.6. Trajnimet për të punësuarit në AZGJ

AZGJ-ja gjithmonë përpiqet dhe do të vazhdojë t'i përmirësojë dhe t'i perfeksionojë aftësitë dhe kapacitetet profesionale të të punësuarve të saj, dhe në këtë kuadër, në vitin 2021 realizoi trajnime për forcimin e kompetencave dhe aftësive të punës të të punësuarve të saj për t'i arritur objektivat e punës për efikasitet në mënyrë ekonomike dhe efektive.

Gjithashtu, me ndihmën e Misionit të OSBE-së ka filluar të planifikojë një aktivitet për disa ditë trajnim të përkthimit simultan për të punësuarit e saj të angazhuar në Sektorin e përkthimit dhe të lekturës, i cili është planifikuar të zhvillohet në gjysmën e parë të vitit 2022, me angazhimin e ligjëruesve me përvojë të fushës të cilët do të angazhohen nëpërmjet Misionit të OSBE-së në Shkup.

Në hotelin "Arka" në Shkup, në periudhën prej 1 deri më 3 shtator është mbajtur trajnimi për menaxhimin e ciklit të projektit dhe menaxhimin e projekteve, në të cilin kanë marrë pjesë gjithsej 20 persona të punësuar në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së.

Realizimi i trajnimit u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup në pajtim me Planin vjetor të veprimit që rezulton nga nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për periudhën 2021- 2024. .

Përveç financimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e trajnimit, Misioni i OSBE-së në Shkup siguroi ekspertizën e nevojshme me angazhimin e dy ekspertëve të fushës (Sunçica Sazdovska dhe Valentina Çiçeva) dhe në bashkëpunim me AZGJ-në i koordinoi aktivitetet e nevojshme në lidhje me mirëmbajtjen e suksesshme të trajnimit.



Pjesa përmbajtësore e trajnimit përfshinte ligjërata në fushën e menaxhimit të projekteve; fazat e ciklit të projektit; planifikimi i projektit i dedikuar drejt qëllimit; identifikimin e problemeve dhe qëllimeve; analiza e gjendjes; kriteret e përzgjedhjes, përzgjedhja e një strategjie projekti, si dhe prezantimi i Planit strategjik të AZGJ-së dhe puna në grupe në ushtrime praktike.

Në periudhën 10-12 nëntor 2021 në hotelin "Akualina" në Ohër është realizuar trajnimi tematik për të punësuarit në AZGJ. Trajnimi ishte i ndarë në dy pjesë, të cilat përfshinin temat "Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja" dhe "Angazhimi në vendin e punës", ndërkaq pas përfundimit të trajnimit, secilit pjesëmarrës iu nda certifikatë për pjesëmarrje në trajnim.



Në periudhën 29-30 nëntor 2021 në hotelin "Gardenia" në Veles u mbajt trajnimi për krijimin e kapaciteteve të zyrtarëve për të rinjtë për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, ku mori pjesë edhe përfaqësuesi i AZGJ-së si zyrtar për të rinjtë. Realizimi i trajnimit u mbështet nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe qëllimi i tij ishte rritja e njohurive për pjesëmarrjen rinore dhe politikat rinore në nivel lokal, kombëtar dhe europian, tendencat dhe sfidat aktuale rinore, komunikimi efektiv me të rinjtë dhe shoqërinë civile rinore, si dhe roli i zyrtarëve për të rinjtë në zbatimin e politikave rinore.



4.7. Parashtresat nga personat fizikë dhe juridikë

Në vitin 2021, në AZGJ u dorëzuan 2 (dy) parashtresa, ku në bazë të përmbajtjes së tyre, u vërtetua nëse ajo është në kompetencë të AZGJ-së. Parashtruesi merr përgjigje profesionale në kohë, e nëse parashtresa nuk është në kompetencë të AZGJ-së, ajo përcillet tek organi kompetent, ku informohet edhe dorëzuesi i parashtresës se te cili organ është dërguar për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për të vepruar sipas saj.

Parashtresat kanë të bëjnë me çështje që lidhen me kufizimet në aspektin e zbatimit të gjuhës zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (gjuha shqipe) në procedurë gjyqësore dhe në procedurë për realizimin e të drejtës së qytetarit në procedurë administrative dhe ato përcillen për shqyrtim dhe veprim të mëtejshëm në Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve si organ kompetent i procedimit të tyre.

4.8. Informimi

AZGJ-ja në mënyrë të vazhdueshme ka punuar për ngritjen e vetëdijes së popullatës dhe të institucioneve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjuhësore. Komunikimi u realizua në mënyrë të drejtpërdrejtë, me qytetarët, me sektorin joqeveritar dhe me përfaqësuesit e institucioneve, nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit (në mënyrë elektronike, nëpërmjet ueb-faqes së AZGJ-së, takime pune, takime në terren e të tjera).

4.9. Buletini mujor

AZGJ-ja në nivel mujor përgatit buletinin për aktivitetet, me qëllim që të përmirësohet transparenca në punë.

Buletini çdo muaj shpallet në ueb-faqen zyrtare të AZGJ-së, në gjuhën maqedonase, atë shqipe dhe në atë angleze, dhe përmban një pasqyrë të shkurtër të aktiviteteve mujore që janë realizuar.



Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
BULETINI
JANAR 2021

4. 10. Ueb-faqja zyrtare dhe mediet digjitale

Ueb faqja zyrtare e AZGJ-së - www.apj.gov.mk dhe www.azgj.gov.mk, vazhdimisht përditësohet me përmbajtje informative në 3 (tri) gjuhë, lidhur me aktivitetet e AZGJ-së, me qëllim që të ruhet parimi i transparencës dhe mundësisë së AZGJ-së për qasje te publiku më i gjerë.

AZGJ-ja shpërndan aktivitetet lidhur me punën e saj edhe në rrjetet sociale Facebook dhe në YouTube.






4.11. Fjalori elektronik VERBIS

Një risi në punën e AZGJ-së është krijimi i një fjalori kontekstual interpretues elektronik VERBIS në formën e një fjalori përshkrues dygjuhësh, maqedonisht dhe shqip. Ai shpjegon leksikisht fondet e fjalëve më të përdorura në të dyja gjuhët.


Në fazën e parë fjalori përmban vetëm 1 modul (administrativo-juridik), ndërsa në të ardhmen planifikohet të përmirësohet me module të reja në fushën e terminologjisë ekonomiko-financiare, shëndetësore, terminologjisë së përgjithshme etj.

Për nga vëllimi, fjalori përmban fillimisht 10.000 fjalë nga fusha administrativo-juridike dhe do të përditësohet vazhdimisht me terma të rinj. Fjalori gjendet në www.verbis.gov.mk.



4.12. Botimet e shtypura dhe ato elektronike







4.13. Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, përveç 6 (gjashtë) memorandumeve të bashkëpunimit të lidhura në vitin 2019 dhe 2020, në vitin 2021 e bën formale bashkëpunimin me subjektet e reja institucionale nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, duke nënshkruar edhe 5 (pesë) memorandume bashkëpunimi, si dhe është nisur procedura për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me Universitetin "Aleksandër Xhuvani" nga Elbasani, Republika e Shqipërisë.

Në vazhdim jepet renditja kronologjike e memorandumeve të bashkëpunimit, të nënshkruara në vitin 2021.

15 qershor 2021 – Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Qendrës së Studimeve dhe të Botimeve për Arbëreshët



1 shtator 2021 - Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Organizatës së Sigurisë dhe të Bashkëpunimit Europian – Misioni në Shkup



29 shtator 2021 - Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar midis Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike – Tiranë



22 nëntor 2021 – Marrëveshja e nënshkruar për bashkëpunim ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Universitetit "Ukshin Hoti" – Prizren



17 dhjetor 2021 – Memorandumi i bashkëpunimit, i nënshkruar ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe dhe Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës



4.14. Pasqyra e akteve të shpallura në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në pajtim me nenin 17, paragrafi (1) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.7/2019), të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e institucioneve sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, që shpallen në Gazetën Zyrtare të RMV-së, shpallen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

AZGJ-ja përgatiti pasqyrë statistikore të të gjitha akteve të shpallura në vitin 2021 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që përbëhet nga institucionet sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Në bazë të pasqyrës së përgatitur, është vërtetuar përqindja e pajtims së institucioneve në aspektin e implementimit të detyrimit sipas nenit 17 të ligjit.

Tabela 4. Pasqyrë e akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" në vitin 2021

Nr. rendor	EMRI I INSTITUCIONIT	Gjithsej botime të shpallura	Botime të shpallura vetëm në gjuhën maqedonase	Botime të shpallura në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj	Përqindja e pëlqimit me detyrimin sipas nenit 17 të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve (%)
1	QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	212	212	0	0%
2	KRYETARI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	17	17	0	0%
3	KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	60	0	60	100%
4	MINISTRIA E PUNËS DHE E POLITIKËS SOCIALE	34	34	0	0%
5	MINISTRIA E FINANCAVE	12	12	0	0%
6	MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	24	24	0	0%
7	MINISTRIA E DREJTËSISË	25	25	0	0%
8	MINISTRIA E BUJQËSISË, E PYLLTARISË DHE E EKONOMISË SË UJËRAVE	12	12	0	0%
9	MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	6	0	6	100%

10	MINISTRIA E SHËNDETËSISË	6	6	0	0%
11	MINISTRIA E EKONOMISË	12	12	0	0%
12	MINISTRIA E MBROJTJES	6	6	0	0%
13	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS	19	19	0	0%
14	MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E LIDHJEVE	13	13	0	0%
15	MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	10	8	2	20%
16	MINISTRIA E KULTURËS	8	8	0	0%
17	MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE	4	4	0	0%
18	BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	20	17	3	15%
19	AGJENCIA E KADASTRËS SË PATUNDSHMËRIVE	18	18	0	0%
20	AGJENCIA E USHQIMIT DHE E VETERINARISË	28	28	0	0%
21	AGJENCIA E REZERVAVE TË DETYRUESHME TË NAFTËS	1	1	0	0%
22	AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMIT PENSIONAL TË FINANCUAR NË MËNYRË KAPITALE (MAKORA)	9	5	4	44,44%
23	AGJENCIA E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	12	12	0	0%
24	AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE, AUDIO DHE AUDIOVIZUALE	7	7	0	0%
25	AGJENCIA E TË RINJVE DHE E SPORTIT	2	2	0	0%
26	AGJENCIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE	12	9	3	25%
27	AGJENCIA E POSTAVE	1	1	0	0%
28	AGJENCIA E BARNAVE DHE E PAJISJEVE MJEKËSORE (MALMED)	3	3	0	0%
29	KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË	53	0	53	100%
30	KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT	115	0	115	100%
31	FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR	7	6	1	14,29%
32	FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR	2	2	0	0%
33	KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE	12	0	12	100%

34	ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS	12	9	3	25%
35	GJYKATA KUSHTETUESE	21	21	0	0%
36	GJYKATA SUPREME	1	1	0	0%
37	NP E FURNIZIMIT ME UJË "STUDENÇICA" - KËRÇOVË	1	1	0	0%
38	KËSHILLI I PROKURORËVE PUBLIKË	13	13	0	0%
39	KËSHILLI GJYQËSOR	31	4	27	87,10%
40	KOMISIONI I MBROJTJES NGA DISKRIMINIMI	2	2	0	0%
41	DHOMA E NOTERËVE	2	2	0	0%
42	DREJTORIA E SIGURISË NGA RREZATIMI	1	1	0	0%
43	DREJTORIA E SIGURISË SË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA	1	1	0	0%
44	AKADEMIA E TRAJNIMIT TË GJYKATËSVE DHE TË PROKURORËVE PUBLIKË	2	2	0	0%
45	DHOMA E STOMATOLOGËVE	1	1	0	0%
46	PROKURORIA PUBLIKE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	2	2	0	0%
47	DREJTORIA E FARËS DHE E MATERIALIT MBJELLËS	1	1	0	0%
48	SHA MEPSO	5	5	0	0%
49	AGJENCIA E RREGULLIMIT TË SEKTORIT HEKERUDHOR	2	2	0	0%
50	GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	2	2	0	0%
51	AVOKATI I POPULLIT	212	2	0	0%
52	AGJENCIA E CILËSISË DHE E AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE	17	1	0	0%
53	AGJENCIA E MBËSHTETJES FINANCIARE NË BUJQËSI DHE NË ZHVILLIM RURAL	60	1	0	0%
54	AGJENCIA E SIGURISË KOMBËTARE	34	1	0	0%
55	DHOMA E PROKURORËVE	12	15	0	0%
56	KOMUNA E BËRVENICËS	24	0	1	100%

5.1. Buxheti, llogaria përmbyllëse dhe financimi

AZGJ-ja si organ shtetëror i pavarur është shfrytëzues i buxhetit.

Në vitin 2021, buxheti i përgjithshëm bazë i AZGj-së, i miratuar, ishte 46.078.000,00 denarë. Me dy ribalancet e buxhetit për vitin 2021, buxheti bazë i AZGj-së është reduktuar në vlerë të përgjithshme prej 42.924.000,00 denarë.

Nga shuma e përgjithshme e mjeteve buxhetore të miratuara pas dy ribalancave të kryera, 39.70% ishin të destinuara për paga dhe shtesa, 29.76% për mallra dhe shërbime, dhe 30.54% për shpenzime kapitale.

Tabela 5. Struktura e buxhetit të AZGJ-së për vitin 2021

Zëri	Përshkrimi	BUXHETI PËR VITIN 2021 (në kundërvlerë denari)					RIBALANCA E BUXHETIT PËR VITIN 2021 (përfshirë të dy ribalancat)	
		Buxheti (630)	Shpenzime nga të ardhurat prej organeve (631)	Shpenzimet nga aktivitete vetëfinancue se (787/788)	Shpenzi me nga donacio- ne (785)	Gjithsej shpenzi- me	Gjithsej shpenzime	Përqindja e realizimit (%) (përfshirë të dy ribalancat)
40	Rroga dhe kontribute	18.638.000,00	/	/	/	/	17.038.000,00	90,36%
401	Rrogat bazë	13.606.000,00	/	/	/	/	12.146.000,00	93,99 %
402	Kontribute të sigurimit social	5.032.000,00	/	/	/	/	4.492.000,00	98,33%
404		0,00					400.000,00	78,75%
42	Mallra dhe shërbime	14.440.000,00	/	/	/	/	12.774.500,00	78,95%
420	Shpenzime ditore dhe rrugore	500.000,00	/	/	/	/	5.000,00	81,92%
421	Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	1.620.000,00	/	/	/	/	1.622.000,00	79,72%
423	Materiale dhe inventari i imët	720.000,00	/	/	/	/	376.000,00	61,79%


424	Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme	600.000,00	/	/	/	/	602.000,00	84,45%
425	Shërbime kontraktuese	9.000.000,00	/	/	/	/	8.866.000,00	97,98%
426	Shpenzime të tjera rrjedhëse	2.000.000,00	/	/	/	/	1.303.500,00	67,83%
48	Shpenzime kapitale	13.000.000,00	/	/	/	/	13.111.500,00	94,16%
480	Blerja e pajisjeve dhe makinerive	1.500.000,00	/	/	/	/	1.500.000,00	95,73%
481	Objekte ndërtimi	750.000,00	/	/	/	/	0,00	0,00%
483	Blerja e mobilieve	750.000,00	/	/	/	/	2.191.500,00	99,86 %
485	Investime dhe pasuri jofinanciuese	10.000.000,00	/	/	/	/	8.420.000,00	81,19%
486	Blerja e automjeteve	0,00	/	/	/	/	1.000.000,00	100%

5.2. Furnizimet publike


1. Numri i vendimeve të marra për furnizime publike: 13
2. Numri i shpalljeve publike për furnizime publike në SEFP: 13
3. Numri i procedurave të filluara me bisedime pa shpallje paraprake: 0
4. Numri i vendimeve të miratuara për përzgjedhjen e ofertës më të volitshme: 12
5. Numri i procedurave të anuluara: 3
6. Vlera e kontratave të lidhura për furnizime publike: 9.889.312,00 denarë pa TVSH, respektivisht 10.764,006 me TVSH.

Vendime të miratuara për furnizime publike	Shpallje të publikuara në SEFP	Procedura të iniciuara me negocim pa shpallje paraprake të publikuar	Vendime të marra për zgjedhjen e ofertës më të volitshme	Vendime të miratuar për anulimin e procedurave	Kontrata të lidhura për furnizime publike
13	13	0	12	3	12

Grafiku 5. Buxheti i AZGj-së për vitin 2021 (buxheti bazë dhe pas ribalancit)



Grafiku 6. Struktura e buxhetit të AZGJ-së pas dy ribalanceve (në %)



6.1. Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara

AZGJ-ja në vitin 2021 realizoi bashkëpunim me një numër të madh institucionesh dhe organizatash nëpërmjet takimeve të punës, ngjarjeve, konferencave, seminareve, trajnimeve, takimeve onllajn, sado që punohej në kushte të kufizuara dhe restrikcione në aspektin e lëvizjes dhe kufizimeve në udhëtime apo realizim të vizitave zyrtare, ngjarjeve, takimeve, shkaktuar nga pandemia globale e virusi koronat SARS-*CoV*-2 (Covid-19).

Në vazhdim është raporti i shfaqur si përmbledhje e ngjarjeve të realizuara, takimeve dhe aktiviteteve në vitin 2021.

4 janar 2021

Zëvendëssekretari i përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së, Tahir Hani e vizitoi AZGJ-në

Ditën e parë të punës në vitin 2021, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e filloi me një vizitë të zëvendëssekretarit të përgjithshëm të Qeverisë së RMV-së, Tahir Hani, të cilin sot e priti në zyrën e tij, drejtori Ylber Sela. Gjatë takimit në fjalë u fol për bashkëpunimin shumë të frytshëm ndërmjet këtyre dy institucioneve që kanë pasur deri tani, për ndihmën e ndërsjellë që e kanë ofruar në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, si dhe për shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat e zbatimit praktik të gjuhëve zyrtare. Po ashtu, ata u zotuan se ky bashkëpunim i ngushtë do të vazhdojë edhe gjatë këtij viti, duke theksuar faktin se na presin edhe shumë sfida dhe punë lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



14 janar 2021

Takim onllajn i drejtorit Sela me Komisionin Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit (KSHPK)


Më 14 janar, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, pati një takim onllajn me Biljana Ivanovskën, kryetare e Komisionit Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit (KSHPK) dhe anëtarët e komisionit.

Takimi u zhvillua me kërkesë të drejtorit Sela në mënyrë që të ofrojë mbështetjen e AZGJ-së në fushën e përkthimit dhe të lekturës së dokumenteve zyrtare, të formularëve, të akteve që rrjedhin nga puna e KSHPK-së, duke pasur parasysh se ajo nuk ka kuadro përkthimi dhe lekture.

Kryetarja e KSHPK-së shprehu mirënjohjen për takimin shumë konstruktiv, ofrimin e bashkëpunimit dhe të mbështetjes nga AZGJ-ja, duke theksuar se aktualisht KSHPK-ja nuk ka përkthyes dhe lektor për gjuhën shqipe, dhe derisa kjo situatë të tejkalohet, do të llogarisë në bashkëpunimin e ofruar nga AZGJ-ja, për shkak të mbarëvajtjes së proceseve të punës.

Të dyja palët u zotuan të intensifikojnë bashkëpunimin ndërinstitucional në të ardhmen.





18 janar 2021

AZGJ-ja filloi bashkëpunimin me Këshillin Britanik

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, pati një takim onllajn me drejtoreshën e Këshillit Britanik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Eleonora Zaprova.

Takimi u mbajt me kërkesë të drejtorit Sela, duke marrë parasysh rëndësinë dhe përvojën e Këshillit Britanik në fushën e arsimit, të kulturës, të trajnimit dhe të testimit në gjuhën angleze, si dhe në punën e sektorin civil.



Drejtori Sela e njoftoi bashkëbiseduesen e tij me punën e AZGJ-së, me projektet e planifikuara në të ardhmen, siç është krijimi i një fjalori digjital (maqedonisht-shqip, shqip-maqedonisht, me mundësi për ta përditësuar edhe në anglisht), si dhe fillimin e funksionimit të qendrës së trajnimit të përkthyesve dhe të lektorëve të institucioneve të sektorit publik, e cila do të veprojë në kuadër të AZGJ-së.

Drejtoresha Zaprova u shpreh e hapur për bashkëpunim me AZGJ-në, dhe gjithashtu ndau përvojën e saj në lidhje me zbatimin e trajnimeve dhe testeve gjuhësore, si dhe zhvillimin e një metodologjie për të mësuar një gjuhë joamtare.

Të dyja palët e vlerësuan takimin si shumë të dobishëm dhe ranë dakord që dialogu të vazhdojë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimin në të ardhmen.

18 janar 2021

AZGJ-ja e vazhdon bashkëpunimin me sektorin joqeveritar

Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) sot u mbajt një takim pune në mes drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela dhe drejtorit ekzekutiv të shoqatës së qytetarëve Nansen Qendra e Dialogut Shkup (NQD), Veton Zekolli.



Në kuadër të këtij takimi, zotëri Zekolli për nevojat e bibliotekës së AZGJ-së dhuroi disa ekzemplarë të *Udhëzuesit maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, në botim të NQD-së.

Drejtori Sela u falënderua për ekzemplarët e siguruar të udhëzuesit dhe njëkohësisht e informoi bashkëbiseduesin e tij se gjatë vitit 2021 AZGJ-ja planifikon të ndërmarrë aktivitete për krijimin e një fjalori digjital, si dhe fillimin e aktiviteteve për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve nga institucionet e sektorit publik.

Të dyja palët shprehën gatishmëri për vazhdimin dhe përparimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe bashkëpunimit në projekte me interes të përbashkët.

21 janar 2021

Takim pune i drejtorit Sela me ministrin e Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski dhe zëvendësministrin Nazim Bushi

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , Ylber Sela e vizitoi Ministrinë e Punëve të Brendshme ku realizoi takim pune me ministrin e këtij institucioni, Oliver Spasovski dhe me zëvendësministrin Nazim Bushi.

Me këtë rast, drejtori Sela e informoi ministrin Spasovski për bashkëpunimin tashmë të vendosur me Ministrinë e Punëve të Brendshme si një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm, duke theksuar se në vitin 2020 u përkthyen dhe u lekturuan formularët zyrtarë të kësaj ministrie për nevojat e Seksionit të çështjeve civile.

Gjithashtu, drejtori Sela shprehu interes për promovimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve dhe mirëpriti angazhimin e ministrit Spasovski në zbatimin e detyrimeve të zgjidhjes ligjore për përdorimin e gjuhëve, dhe për realizimin e të drejtave të qytetarëve në procedurat përballë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Të dyja palët e vlerësuan takimin si jashtëzakonisht të dobishëm dhe u zotuan të vazhdojnë dialogun dhe bashkëpunimin e vendosur.



22 janar 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela vizitoi Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, vizitoi Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve, ku pati një takim pune me ministrin Bllagoj Boçvarski dhe zëvendësministrin Bekim Rexhepi.



Gjatë këtij takimi drejtori Sela shfaqi interes për bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe të Lidhjeve në aspektin e zbatimit të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve dhe realizimin e të drejtave të personave fizikë dhe juridikë në procedurat përballë kësaj ministrie. Njëherazi, drejtori Sela i dhuroi disa botime të AZGJ-së dhe ofroi ndihmë profesionale në pjesën e përkthimit dhe lekturimit të formularëve zyrtarë për nevojat e kësaj ministrie.

Të dyja palët u zotuan për ta intesifikuar bashkëpunimin ndërinstitucional.

5 shkurt 2021

Vizitë e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në Komunën e Çashkës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, vizitoi Komunën e Çashkës, ku zhvilloi një takim pune me kryetarin e saj, Goran Stojanovskin.



Duke iu falënderuar për mundësinë e një takimi të drejtpërdrejtë, drejtori Sela e informoi kryetarin Stojanovski se cikli i planifikuar i vizitave në njësitë e vetëqeverisjes lokale fillon pikërisht nga Komuna e Çashkës, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, por që do të realizohet gjatë këtij viti.

Gjithashtu, drejtori Sela kishte rastin që drejtpërdrejt nga terreni ta shohë situatën me zbatimin e gjuhëve zyrtare në Komunën e Çashkës, si njëra nga komunat me sipërfaqe më të madhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku përveç maqedonishtes, gjuhë zyrtare është edhe shqipja dhe alfabeti i saj, duke marrë parasysh përfaqësimin etnik të popullsisë.

Përkundër përparimit të konstatuar, mbetet që të ndërmerren aktivitete të mëtejshme dhe përpjekje shtesë lidhur me ekipimin e komunës për përkthimin dhe lekturimin e dokumentacionit zyrtar, sigurimin e shërbimeve komunale efikase në gjuhët zyrtare për qytetarët, harmonizimin në pjesën e emërtimeve të objekteve të infrastrukturës brenda komunës dhe shkrimin e tyre në gjuhët zyrtare etj. Në këtë pjesë, drejtori Sela ofroi ndihmë profesionale nga ana e AZGJ-së për përkthimin dhe lekturimin e formularëve, kërkesave dhe akteve të tjera zyrtare që përdoren nga qytetarët si shfrytëzues të shërbimeve komunale.

Të dyja palët këtë takim e vlerësuan si tejet të dobishëm dhe frytdhënës, për çka u zotuan për avancimin e bashkëpunimit dhe komunikimit midis dy institucioneve.

9 shkurt 2021

U arrit bashkëpunim ndërinstitucional me Drejtorinë e Doganave

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, e vizitoi Drejtorinë e Doganave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku realizoi një takim pune me drejtorin, Goran Sugareski.

Në takim u shqyrtua gjendja lidhur me zbatimin e detyrimeve të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në Drejtorinë e Doganave, duke përfshirë Drejtorinë Qendrore, doganat rajonale dhe filialet e doganave që funksionojnë në kuadër të tyre.



Drejtori Sela, së bashku me përfaqësuesit e AZGJ-së, Jeton Sulejmani nga Sektori i çështjeve të përgjithshme dhe juridike dhe i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Llazo Matovski nga Sektori i mbështetjes së drejtorit, u informuan hollësisht nga Valentina Pivarova, ndihmësdrejtoreshë në Sektorin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe Zoran Petkovski, ndihmësdrejtor në Sektorin e punëve administrative dhe teknike, për aktivitetet e ndërmarra deri tani nga ana e Drejtorisë së Doganave lidhur me realizimin e detyrimeve që dalin nga zgjidhja ligjore për përdorimin e gjuhëve.

Përkundër mosrealizimit në kohë të detyrimeve të caktuara, në takim u arrit bashkëpunim i përbashkët në nivel të grupeve të punës, me qëllim ndjekjen e gjendjes dhe harmonizimin me dispozitat ligjore.

Në fund të takimit, drejtori Sela dorëzoi një pako botimesh të AZGj-së, ndërkaq u ofrua edhe ndihmë profesionale sa i takon përkthimit të formularëve, si dhe lekturimit të akteve zyrtare për nevojat e Drejtorisë së Doganave.

12 shkurt 2021

Takim pune me kryetaren e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi

Pas vizitës së realizuar në Komunën e Çashkës, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, vizitoi Komunën e Tetovës, ku u prit nga kryetarja, Teuta Arifi.





Nga ana tjetër, drejtori Sela shpalosi të arriturat e AZGJ-së, duke e njoftuar kryetaren Teuta Arifi për fillimin shumë shpejtë të projektit të trajnimit të përkthyesve në institucionet lokale dhe shtetërore.

Drejtori Sela theksoi rëndësinë e përvojës gjuhësore të kryetares Teuta Arifi, si ligjëruese, që në të ardhmen e afërt mund t'i shërbejë edhe nevojave të AZGJ-së.

Në fund të takimit, drejtori Sela ia dhuroi kryetares Arifi një pako botimesh të AZGJ-së që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve

16 shkurt 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela vizitoi Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, sot e vizitoi Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Jetësor (ISHMJ) ku realizoi një takim me Ana Petrovskën, ushtruese detyre e drejtoreshës së Inspektoratit.



Vizita ishte inicuar nga ana e drejtorit Y. Sela me qëllim të kuptimit të situatës lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhës në punën e Inspektoratit, si dhe krijimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për çështjet lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Drejtoresha Petrovska theksoi se janë ndërmarrë hapa në drejtim të harmonizimit të punës së Inspektoratit me detyrimet ligjore, por që ballafaqohen me mungesë të burimeve të kuadrit për përkthim të akteve zyrtare. Megjithatë premtoi se do të bëhen përpjekje për të tejkaluar këtë situatë. Që proceset e punës të mund të zhvillohen pa pengesa, drejtori Sela ofroi mbështetje të plotë në pjesën e ndihmës profesionale për përkthim dhe lekturim të akteve dhe dokumenteve zyrtare, si dhe i dorëzoi një pako botimesh të AZGJ-së.

Në takim u konstatua nevoja për përshtatjen e akteve nënligjore që e përshkruajnë formën dhe përmbajtjen e akteve të inspektimit dhe që i përdor Inspektorati, me qëllim të ofrimit të versioneve gjuhësore të akteve në të dy gjuhët zyrtare.

Në fund të takimit, të dy bashkëbiseduesit riafirmuan angazhimin e tyre për të vazhduar dialogun dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

22 shkurt 2021

Fjalim i drejtorit Sela në tryezën e rrumbullakët të mbajtur në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare

I nderuar zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Sistemit Politik dhe i Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive, z. A. Grubi,

I nderuar zëvendësministër, z. Rahman,

I nderuar sekretar shtetëror i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, z. Beluli,

I nderuar drejtor i Agjencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive, z. Kurtish,

I nderuar drejtor i Inspektoratit Shtetëror të Përdorimit të Gjuhëve, z. Iseni,

I nderuar drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe të Promovimit të Arsimit në Gjuhët e Pjesëtarëve të Bashkësive, z. Stançiq,

I nderuar drejtor i Drejtorisë së Afirmimit dhe të Promovimit të Kulturës së Pjesëtarëve të Bashkësive, z. Ujkanoviq

Me shumë nder dhe kënaqësi e pranova ftesën për të marrë pjesë në tryezën e sotme të rrumbullakët, e cila mbahet në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare.

Më lejoni që me këtë rast, t'i shpreh mirënjohjen time zëvendëskryeministrit Grubi për ftesën që të marr pjesë në ngjarjen e sotme, si dhe për angazhimin e tij personal për zgjidhjen e çështjes hapësinore dhe sigurimin e kushteve për funksionimin e institucioneve publike që kanë kompetenca në fushat të cilat lidhen me pjesëtarët e komuniteteve, për t'u vendosur dhe funksionuar brenda një godine përfaqësuese në të cilën ndodhet Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive.

21 shkurti është caktuar nga UNESCO si Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare dhe kremtohet në të gjitha vendet e botës. Babai i linguistikës moderne, shkencëtari dhe gjuhëtari i famshëm amerikan Noam Çomski, ka thënë: "Gjuhë nuk janë vetëm fjalët. Është kulturë, traditë, bashkim i shoqërisë, një histori e tërë që portretizon shoqërinë ashtu siç është. E gjithë kjo mishërohet nëpërmjet gjuhës." Në këtë kontekst, Republika e Maqedonisë së Veriut në kuptimin e plotë të fjalës e pasqyron kuptimin e termit "diversitet", sepse përfaqëson pasuri nga gjuhët, kulturat dhe fetë e ndryshme që ndërthuren brenda një zone gjeografike.

Diversiteti gjuhësor, karakteri multikulturor dhe multikonfesional i shoqërisë sonë paraqet avantazh, e jo hendikep, dhe si specifika duhet të kultivohen dhe avancohen vazhdimisht në mënyrë që të sigurohet kohezioni shoqëror dhe bashkëjetesa midis komuniteteve. Nuk duhet që t'i nxisë idetë dhe ndarjet nacionaliste, por gjuha duhet të jetë faktor dhe mjet lidhës për veprimin ndëretnik.

Respektimi dhe kujdesi për diversitetin gjuhësor duhet të jetë gjithmonë në fokus të politikave publike për të siguruar përfshirjen e të gjitha komuniteteve duke mbështetur trajtimin e barabartë të diversitetit gjuhësor, përkundër favorizimit të specifikave gjuhësore dhe kulturore vetëm të një etnie. E drejta për të përdorur gjuhën amtare paraqet të drejtën themelore për çdo individ, dhe zhvillimi i proceseve demokratike në një vend varet nga shkalla e realizimit të së drejtës së barazisë gjuhësore dhe respektimi i pluralitetit gjuhësor.

Qëllimi i kësaj dite është të vlerësojmë gjuhën si një mjet të rëndësishëm për zhvillimin, sigurimin e diversitetit dhe dialogut ndërkulturor, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe arritjen e cilësisë në arsim për të gjithë, duke krijuar njëkohësisht shoqëri gjithëpërfshirëse.

Gjuha shqipe është thesari ynë i përbashkët. Prandaj ta duam, ta mbrojmë dhe ta promovojmë atë së bashku brez pas brezi.

Më lejoni, zonja dhe zotërinj, në fund të fjalimit tim, ta falënderoj edhe njëherë organizatorin për ftesën për pjesëmarrjen, si dhe për mundësinë për prononcimin tim në ngjarjen e sotme.





25 shkurt 2021

Ambasadori i Kosovës në Shkup i dorëzoi mirënjohje drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela



Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së në Shkup qëndroi për vizitë ambasadori i Republikës së Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj ku u prit nga drejtori Ylber Sela i cili e njoftoi atë për punën dhe aktivitetet e shumta që bën ky institucion për zbatimin zyrtar të gjuhës shqipe. Me këtë rast ambasadori Gjergj Dedaj, me rastin e 13 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, drejtorit Ylber Sela i dorëzoi mirënjohje për mbështetjen, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe kontributin e tij për çështjen e Kosovës, duke e falënderuar dhe duke i shprehur respekt të veçantë.

26 shkurt 2021

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i dhuroi botimet e saj AZGJ-së

Në bibliotekën e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, arritën një numër i konsiderueshëm botimesh të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Me këtë rast, AZGJ-ja e falënderon publikisht ASHAK-në dhe kryetarin e saj akademik Mehmet Kraja për këtë dhuratë të çmuar. Librat në fjalë u përkasin fushave të ndryshme, sidomos asaj të gjuhësisë dhe do të shërbejnë për nevojat e AZGJ-së.



26 shkurt 2021

Lista me emrat e rrugëve do të lekturohet nga AZGJ-ja para se të publikohet në Gazetën Zyrtare të Qytetit të Shkupit

Ndihma dhe mbështetja e AZGJ-së ndaj institucioneve shtetërore për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, nuk ka munguar asnjëherë dhe vazhdon edhe më tej me intensitet të plotë.

Kështu, sot në selinë e AZGJ-së, qëndroi këshilltarja në Kuvendin e Qytetit të Shkupit, zonja Halide Palloshi, e cila kërkoi ndihmë për lekturimin e listës me emrat e rrugëve.



Pa dyshim, shërbimet e AZGJ-së e morën përsipër lekturimin e kësaj liste, në mënyrë që të shmangen gabimet para zbatimit të saj.

2 mars 2021

AZGJ-në e vizitoi rektori i Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit, prof. dr. Bajram Kosumi

Sot Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së e vizitoi rektori i Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit, prof. dr. Bajram Kosumi, bashkë me profesorin e Universitetit të Kozencës, prof. dr. Anton Berishën, si dhe disa personalitete të tjera të jetës shkencore, kulturore, letrare etj.

Mysafirët i priti drejtori i AZGJ-së, prof. dr. Ylber Sela i cili i njoftoi ata për punën e deritanishme që është bërë në këtë institucion, si dhe për sfidat dhe detyrimet e mëtejme që duhet t'i përmbushë në aspektin e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.



Mysafirët në fjalë u interesuan hollësisht për funksionimin e AZGJ-së dhe e përgëzuan për punën që po bën për sa i përket zbatimit të gjuhës shqipe në nivele zyrtare, si dhe njëkohësisht duke i dhënë mbështetje të plotë.

2 mars 2021

Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela: ITSHKSH-ja ka shërbyer si akademi e shkencave për shqiptarët

Në aktivitetin që e organizoi Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në mjediset e Qendrës Informative Kulturore në Shkup, ku u promovua veprimtaria botuese e këtij institucioni gjatë vitit 2020, morën pjesë personalitete të shumta të jetës politike, shkencore, kulturore e arsimore.

Në mesin e tyre, të pranishmit i përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela i cili e përgëzoi ITSHKSH-në për punën e çmuar që ka bërë gjatë vitit 2020, si dhe vuri në dukje se ky institucion ka shërbyer si një akademi e shkencave për shqiptarët në RMV.





5 mars 2021

Konfirmohet bashkëpunimi i mirë me KRRE-në

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , Ylber Sela, sot e vizitoi Komisionin Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit (KRRE) ku realizoi takim me Marko Bislimoskin, kryetar dhe Atanasko Tuneskin, anëtar i KRRE-së.

Të dyja institucionet kanë vendosur bashkëpunim dhe dialog të mirë me lekturimin e rregullt nga AZGJ-ja të akteve zyrtare për nevojat e KRRE-së të cilat publikohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

KRRE-ja është një nga institucionet që ka bërë përparim të dukshëm në drejtim të zbatimit të dispozitive të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Sa u takon disa çështjeve të caktuara që duhet të harmonizohen në pajtim me detyrimet ligjore, të dyja palët u dakorduan se të njëjtat do të tejkalohen brenda një kohe të shkurtër nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjellë.



Bashkëbiseduesit u zotuan për vazhdim të bashkëpunimit dhe të ruajtjes së dialogut të rregullt për çështje me interes të përbashkët.

9 mars 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela vizitoi SHA M-NAV

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela sot e vizitoi Shoqërinë Aksionare M-NAV, ku u takua me kryetarin e Bordit Drejtues dhe drejtorin ekzekutiv të Sektorit të Navigacionit Ajror, Fahrudin Hamidi. Në këtë takim drejtori Sela e njoftoi atë për punën që po bën AZGJ-ja, duke u ofruar ndihmë institucioneve të ndryshme në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet zyrtare.



Po ashtu, edhe zoti F. Hamidi e njoftoi për vështirësitë dhe nevojat e kësaj kompanie në aspektin e përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve të ndryshme në gjuhën shqipe. Prandaj ai kërkoi ndihmë nga AZGJ-ja që brenda mundësive ta ndihmojë kompaninë në fjalë. Natyrisht, drejtori Y. Sela u zotua se do t'i ofrojë ndihmë konkrete për përkthimin dhe lekturimin e formularëve, akteve administrative, si dhe të dokumenteve tjera zyrtare të kësaj kompanie.

10 mars 2021

Takim pune në Komunën e Zelenikovës

Pas takimeve të realizuara në komunat e Çashkës, Tetovës dhe asaj të Butelit, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, e vizitoi Komunën e Zelenikovës, ku u prit nga kryetari Borçe Gievski.

Vizita u realizua me nismë të drejtorit Sela, me qëllim këqyrjen e gjendjes rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë njësi të vetëqeverisjes lokale, në të cilën rreth 30%, sipas të dhënave statistikore nga regjistrimi i fundit i popullatës, janë shqiptarë. Drejtori Sela ofroi bashkëpunim dhe theksoi se AZGJ-ja, do t'i ndihmojë komunës në procesin e harmonizimit të punës së saj me rregullativën ligjore pozitive.



Nga ana e tij, kryetari Gievski shprehu gatishmëri dhe vullnet që të përmirësohet gjendja rreth përdorimit të gjuhës shqipe, nëpërmjet procesit të bashkëpunimit dhe mbështetjes së AZGJ-së.

Në fund të takimit, drejtori Sela, i dorëzoi kryetarit Gievski një përmbledhje me publikime të AZGJ-së, të lidhura këto me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

15 mars 2021

Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela në takim pune në Komunën e Petrovecit

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, sot ishte në vizitë të Komunës së Petrovecit, ku u prit nga kryetari i saj, Borçe Mitevski. Vizita u realizua me nismë të drejtorit Sela, me qëllim këqyrjen e gjendjes së zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, në të cilën rreth 23% e popullsisë janë shqiptarë, sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit, si edhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare.



Për arsye të rrjedhjes së pandërprerë të proceseve të punës, drejtori Sela ofroi mbështetje profesionale për përkthimin dhe lektorimin e formularëve dhe dokumenteve zyrtare.

Nga ana tjetër, kryetari Borçe Mitevski shprehu gatishmëri dhe vullnet të përmirësohet gjendja e përdorimit të gjuhës shqipe, përmes procesit të bashkëpunimit dhe të mbështetjes së AZGJ-së.

Në fund të takimit, drejtori Sela i dha kryetarit Mitevski një përmbledhje me publikime të AZGJ-së, lidhur me implementimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

19 mars 2021

Takim i frytshëm i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela me ministren e Kulturës, Irena Stefoska

Me ftesë të ministres së Kulturës të RMV-së, Irena Stefoska, sot drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij, Ahmet Selmani dhe Liljana Pandeva, zhvilloi një takim pune. Qëllimi i këtij takimi ishte konsultimi për disa çështja nga sfera e humanistikës që kanë të bëjnë me përkthyesit dhe përkthimin në RMV.

Sipas ministres Stefoska patjetër duhet të kthehet dinjiteti i përkthyesve vendës, prandaj është e domosdoshme mbështetja dhe stimulimi i tyre. Duke u nisur nga kjo, ajo propozoi që të hartohet një program për mbështetjen e përkthyesve, përkatësisht stimulimin e tyre në vendin tonë. Po ashtu ajo hodhi idenë që të hartohet edhe një program për përkthime të kryqëzuara, siç i quajti ajo, domethënë përkthime nga autorë maqedonas në shqip dhe nga autorë shqiptarë në maqedonisht.

Krahas këtyre, ajo propozoi edhe një program për furnizimin e disa bibliotekave në qytetet tona me botime (përkthime) nga Shqipëria, pra si një import intervenues për pasurimin e bibliotekave, sepse numri i lexuesve është i lakmueshëm. Por paraprakisht ranë dakord që të organizohet një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar me përkthyes, bibliotekarë, botues etj., dhe për të ndërtuar një strategji lidhur me këtë çështje. Gjatë takimit në fjalë, si pikë të veçantë ajo e shtroi edhe çështjen e licencave për lektorë në gjuhën shqipe, me qëllim që të zgjidhet statusi i tyre njësoj si ai i lektorëve për gjuhën maqedonase.



Për të gjitha këto ide e propozime ranë dakord të dyja palët, që të mbështeten përkthyesit në RMV, si dhe të diskutohen bashkërisht të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përkthimin dhe lekturën.

24 mars 2021

AZGJ-në e vizitoi një grup studentësh të UT-së

Sot, një grup studentësh të vitit të katërt të Universitetit të Tetovës (UT), të cilët studiojnë në Fakultetin e Administratës Publike, në Programin e administratës publike, të shoqëruar nga profesori i tyre, Jahi Jahiu, e vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGJ).

Ata i priti drejtori Ylber Sela dhe bashkëpunëtorët Valmira Axhirexha dhe Jeton Sulejmani.

Me këtë rast, drejtori Sela u uroi mirëseardhje, duke u dëshiruar sukses në drejtimin e tyre studimor. Ndërkaq, Valmira Axhirexha dhe Jeton Sulejmani prezantuan një material më të zgjeruar për AZGJ-në, për ngritjen si institucion, sfidat, punën e deritanishme dhe synimet për të ardhmen.



Gjithashtu, studentëve u dhuruan botimet e AZGJ-së. Kjo vizitë do t'u shërbejë atyre për t'u njohur nga afër me punën në administratën publike, ku në të ardhmen mund të jenë pjesë e saj.

24 mars 2021

Drejtori Sela priti Kaltrina Beqirin, drejtoreshë në Agjencinë e Cilësisë dhe të Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore

Sot në hapësirat e AZGj-së qëndroi Kaltrina Beqiri, drejtoreshë në Agjencinë e Cilësisë dhe të Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, e cila bashkë me ekipin e saj realizuan takim me drejtorin e AZGJ-së, Ylber Selën për t'u konsultuar rreth disa çështjeve sa i takon përdorimit dhe zbatimit të gjuhës shqipe në institucionin që ajo drejton.

Gjatë këtij takimi, drejtori i AZGJ-së Ylber Sela dhe drejtoresha Beqiri biseduan lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore, ndërsa me këtë rast drejtori i AZGJ-së Ylber Sela i ofroi mbështetje të plotë duke premtuar edhe ndihmë nga shërbimet e AZGJ-së në aspektin e përkthimit dhe të lekturës së dokumenteve dhe të akteve zyrtare.



Bashkëbiseduesit ranë dakord për bashkëpunim të mëtutjeshëm në mes dy institucioneve, në mënyrë që zbatimi i dispozitave të ligjit të jetë në nivelin e duhur në këtë institucion.

30 mars 2021

Thellohet bashkëpunimi i AZGJ-së me Fakultetin Filologjik të UT-së

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGJ) qëndroi profesor Berton Sulejmani, dekan i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës (UT), i cili u prit nga drejtori i agjencisë, Ylber Sela.

Me këtë rast, dekani Sulejmani dhuroi të gjithë numrat e revistës "Filologjia" si dhe të revistës "Albanologjia", ku botohen punimet e një prej ngjarjeve më të rëndësishme në RMV, Seminari Albanologjik, që është një projekt i UT-së.

Gjithashtu, AZGJ-së iu dërguan edhe materialet onllajn, për të pasur qasje më të lehtësuar.

Dekani Sulejmani takoi edhe përkthyesit dhe lektorët e AZGJ-së me të cilët diskutoi edhe për trajnimin e përkthyesve dhe lektorëve të institucioneve publike që do të fillojë në muajin prill në zyrat e AZGJ-së.





Drejtori Sela dhe dekani Sulejmani biseduan për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet AZGJ-së dhe Fakultetit Filologjik të UT-së për të hapur një drejtim të ri studimor në UT – atë të redaktimit gjuhësor.

1 prill 2021

Biblioteka e AZGJ-së u pasurua me botime të reja

Falë Misionit të OSBE-së në Shkup, biblioteka e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së (AZGJ) u pasurua me botime të reja, të siguruara nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare, me seli në Hagë, Mbretëria e Holandës.



5 prill 2021

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës filloi trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të sektorit publik

Prej sot, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës do të trajnojë 66 përkthyes dhe lektorë të institucioneve të ndryshme të administratës. Siç i informoi drejtori i agjencisë, Ylber Sela, në hapjen solemne, ky është trajnimi i parë i këtij lloji në vendet e rajonit.

Sela tha se agjencia, që në fillim të punës së saj, ka vërejtur një sërë problemesh në përdorimin e gjuhëve, veçanërisht në përdorimin e terminologjisë, prej nga dhe doli nevoja për harmonizim të saj në gjuhët që përdoren në administratë. Edhe qëllimi i këtij trajnimi është përshtatur sipas nevojave të përkthyesve dhe lektorëve të të gjithë institucioneve, të organeve të administratës, së pari të ministrive, të ndërmarrjeve publike dhe të gjykatave, për çka janë angazhuar profesorët më eminentë nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria.

Ai përkujtoi se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës tashmë ka botuar një doracak për administratorët, që është i pari në rajon i këtij lloji dhe planifikon edhe hartimin e një softueri të terminologjisë juridike e administrative, që do të jetë një ndihmesë e madhe praktike për administratën.

Trajnimin e përshëndeti edhe ministrja e Kulturës, Irena Stefoska, e cila midis të tjerash theksoi se kujdesi për gjuhën është pasuria më e madhe që mund ta ketë një popull dhe se kemi përgjegjësi të madhe si shoqëri dhe qytetarë, që t'i kultivojmë gjuhët që fliten në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Siç ka thënë linguisti i njohur dhe miku i madh yni, prof. Viktor Fridman, Maqedonia është zemra e kontakteve ballkanike", theksoi Stefoska.

Duke përshëndetur iniciativën për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve, ministrja Stefoska, tha se nevojat për njohje profesionale të gjuhëve dhe zbatimit të tyre në sferën publike është thelbësore për funksionimin e jetës së përditshme. Kjo nënkupton unifikim të terminologjisë profesionale në gjuhët që përdoren në vend dhe ngritjen e cilësisë së përdorimit të tyre. Ministrja Stefoska tha se angazhohet për kthimin e dinjitetit të punës së përkthyesve, kurse paralajmëroi edhe licencimin e lektorëve në gjuhën shqipe, në të njëjtën mënyrë siç është i rregulluar statusi i lektorëve të gjuhës maqedonase.

Punë të mbarë e të suksesshme ju uroi pjesëmarrësve të trajnimit edhe Sekretari Shtetëror i Ministrisë së Sistemit Politik, Rami Qerimi.



Trajnimet ishin paraparë të mbahen në tri grupe, ku do të trajtoheshin tema të ndryshme nga fusha e përkthimit, si një ndihmesë praktike në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në RMV, por për shkak të masave të reja të qeverisë nga situata me Kovid-19, trajnimet do të shtyhen për një periudhë të caktuar, me ç'rast kandidatët pjesmarrës do të njoftohen me kohë për mbajtjen e tij.



6 maj 2021

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) vazhdon me trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve

Pas ndërprerjes njëmujore për shkak të masave kundër pandemisë, sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës vazhdoi trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të sektorit publik, punën e të cilëve e përshëndetën kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, ambasadori Klemens Koja dhe zëvendëssekretari i përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së, Tahir Hani. Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i njoftoi pjesëmarrësit se programi i trajnimit do të zgjasë tre muaj.

Për shkak të pandemisë ata janë ndarë në gjashtë grupe nga dhjetë veta. Ai shtoi se për këtë qëllim janë zgjedhur profesorë eminentë të fushës së gjuhësisë dhe të terminologjisë përkatëse administrative nga Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria. Çdo institucion ka dërguar përfaqësues të vet dhe trajnimet do të mbahen aq sa do të ketë nevojë"

Duke i përshëndetur pjesëmarrësit e grupit të tretë të trajnimit, kryetari i Kuvendit të RMV-së, Talat Xhaferi, tha se prej çastit kur u themelua Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, e ka arsyetuar ekzistimin e vet dhe vazhdon edhe më tej me një vrull për admirim, të zbatojë aktivitetet e duhura për të respektuar dispozitat ligjore dhe detyrimet kushtetuese të të gjitha palëve. Kryetari Xhaferi përshëndeti ambasadorin e OSBE-së, Klemens Koja, i cili, sipas tij, me përkushtim dhe përzemërsi e mbështet punën e agjencisë, por edhe atë të të gjitha institucioneve të tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjuha është materie e gjallë, vazhdimisht nën ndikim të rrjedhave, ndikimeve të ndryshme dhe andaj duhet të përshtatet, të modernizohet por, jo edhe të teprohet sepse, asgjë nuk mund të krahasohet dhe të tingëllojë më bukur se gjuha e pastër, standarde por përsëri, burimore, vuri në dukje midis tjerash Talat Xhaferi, duke i përshëndetur dhe duke u uruar punë të mbarë pjesëmarrësve.

Nëpërmjet platformës "Zoom", ambasadori Klemens Koja, shef i Misionit të OSBE-së në Shkup, e përshëndeti nismën e AZGJ-së për trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të sektorit publik. Ai tha: "Ne në Misionin e OSBE-së në Shkup besojmë se ruajtja e të drejtave individuale dhe të bashkësisë, respektimi i dallimeve, promovimi i larmisë etnike, kulturore e gjuhësore, si dhe nxitja e bashkëveprimit ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë, janë jetike për një shoqëri të pasur, gjithëpërfshirëse për të gjithë".





Ambasadori Koja shprehu kënaqësinë e tij për mundësinë e bashkëpunimit me AZGJ-në, që nga themelimi i saj, duke shtuar se ky mision mbetet i përkushtuar në mbështetjen e të gjitha tentimeve për të konsoliduar sistematikisht një shoqëri gjithëpërfshirëse. Këtë e bëjmë në partneritet me të gjithë autoritetet, siç është Agjencia e Zbatimit të Gjuhës.

Në emër të Qeverisë së RMV-së foli zëvendëssekretari i përgjithshëm, Tahir Hani, i cili në fillim citoi një mendimtar që ka thënë se çështja e gjuhës është tepër serioze që t'u lihet vetëm gjuhëtarëve, që do të thotë se edhe bartësit e funksioneve duhet të angazhohen për krijimin e terminologjisë dhe të standardeve të qëndrueshme.

Përkthimi, lekturimi, por edhe korrektura, janë procese të lidhura ngushtë dhe plotësojnë njëra tjetrën, tha ai, duke shtuar se Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RVM-së ka përkrahur dhe do të vijojë të mbështesë Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në përgatitjen e kuadrit profesional. Hani shprehu besimin e

tij se trajnimet do të kontribuojnë në avancimin e standardeve për zbatimin e drejtë të gjuhës shqipe. Ai, po ashtu, tha se sot situata në këtë drejtim ka avancuar, edhe pse akoma ka institucione të cilat nuk kanë siguruar numër të mjaftueshëm të përkthyesve, por dhe institucione që hasin në vështirësi kur është në pyetje terminologjia gjuhësore.

17 maj 2021

Java e dytë e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve që organizon AZGJ-ja

Me ligjëratat e profesorëve të gjuhës, prof. dr. Asllan Hamiti dhe prof. dr. Ismet Osmani, sot ka filluar java e dytë e trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve të sektorit publik, të ndarë në gjashtë grupe.

Prof. dr. Asllan Hamiti, profesor i katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin "Cirili dhe Metodi", sot dhe në ditët në vijim, me pjesëmarrësit e trajnimit trajton rasat dhe frazeologjizmat në gjuhën shqipe dhe format e barasvlershme në gjuhën maqedonase.

Ky trajnim, si çdo lloj trajnimi tjetër, është mjaft i dobishëm. Në të, përkthyesit e institucioneve të ndryshme, takohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, këmbejnë përvoja të ndërsjella. Por, nga ana tjetër, në këtë trajnim ligjërojnë profesorë eminentë në fusha të ndryshme të gjuhësisë, të cilët me njohuritë e tyre të thella teorike, u ndihmojnë pjesëmarrësve që t'i zgjidhin problemet praktike, shprehet ai.

Temë boshte që trajtuam sot dhe do të trajtojmë në ditët në vijim me të gjitha grupet, është gramatika krahasuese midis shqipes dhe maqedonishtes dhe vëmendje të posaçme do t'u kushtojmë formave rasore të shqipes dhe barasvlerësve të tyre me maqedonishten. Po kështu, me rëndësi janë edhe frazeologjimat në të dyja gjuhët, sepse kanë specifikat e tyre", shprehet ai, duke përfunduar se këto dy tema janë tepër të rëndësishme për punën e përkthyesve, sepse përbëjnë problemin kryesor në përkthim.

Prof. dr. Ismet Osmani, që po ashtu është profesor i katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin "Shën Cirili dhe Metodi", në ligjëratat e tij do të trajtojë çështjen e terminologjisë, me të cilën ballafaqohen çdo ditë përkthyesit dhe lektorët.



Temat që do t'i trajtoj janë nga fusha e ligjërimit të specializuar-terminologjia profesionale. Terminologjia përbën një nga nënsistemet e rëndësishme leksikore, që mendoj se gjatë trajtimit do të përpiqemi t'i gjejmë barasvlerësit në gjuhën shqipe, për të shmangur huazimet (vërshimet) e panevojshme nga gjuhët e huaja, thotë prof. dr. Ismet Osmani.

Ai mendon se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës bën një detyrë të madhe në avancimin e njohurive dhe shkathtësive të përkthyesve, të punësuar në institucionet e shtetit, në procesin shumë të rëndësishëm të përkthimit gjatë zbatimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare.

Mendoj se ky trajnim do t'ua lehtësojë punën dhe mbi të gjitha do t'i motivojë përkthyesit dhe lektorët për të qenë më kreativë në fushën e përkthimit, nënvizoi prof. I. Osmani.

1 qershor 2021

Ligjërata të prof. dr. Xhelal Zejnelit për teknologjitë e përkthimit

Në javën e katërt të trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve të sektorit publik, organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, u inkuadrua edhe prof. dr. Xhelal Zejneli, me ligjëratat e tij për teknologjitë e përkthimit.

Përkthimi është një fushë specifike, e përmban mjeshtërinë dhe artin e vet, është veprimtari profesionale të cilën mund ta ushtrojnë vetëm personat me përgatitje universitare përkatëse, – thotë prof.dr. Xhelal Zejneli, në njërën nga pushimet e ligjëratave.

Në temën e trajtuar për teknologjinë e përkthimit, kandidatët u njoftuan me të gjitha problemet dhe vështirësitë, me të cilat mund të ballafaqohet një përkthyes gjatë ushtrimit të profesionit të vet. Është një punë tejet komplekse, që nënkupton përgjegjësi të madhe profesionale dhe morale, që kërkon edhe njohuri fushash të ndryshme, nënvizon ai.



Ai përshëndet këtë aktivitet të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, si një ndërmarrje të shkëlqyer që do të rezultojë me rritjen e cilësisë së përkthimit, që do të sensibilizojë opinionin dhe institucionet e shtetit për domosdoshmërinë e zbatimit të shqipes si gjuhë zyrtare në këtë vend.

Mendoj se kjo praktikë e trajnimit nuk duhet të ndërpritet, por duhet të vazhdojë edhe në faza të tjera, gjithmonë në funksion të krijimit të një kuadri sa më profesional, tha ai, duke nënvizuar edhe punën e deritashme të AZGJ-së.

Drejtorit të AZGJ-së, profesor Ylber Selës, i dëshiroj sukses në punë edhe në aktivitetet e ardhshme. Ai, që në ditën e parë të ardhjes në këtë detyrë të përgjegjshme, ka bërë çmos që ta çojë para punën e kësaj agjencie, gjithmonë në funksion të jetësimit të shqipes si gjuhë zyrtare në vendin tonë – tha midis të tjerash prof. dr. Xhelal Zejneli.

Profesor Xhelal Zejneli, pos njohurive të një linguisti, ka edhe përvojën e përkthyesit, të fituar në institucione të ndryshme shtetërore para më shumë se tri dekadash, që është e çmueshme për pjesëmarrësit në këto trajnime.

2 qershor 2021

AZGJ-ja dhe Avokati i Popullit në shërbim të mbrojtjes së të drejtave gjuhësore të qytetarëve

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , Ylber Sela, sot pati takim zyrtar me Avokatin e Popullit z. Naser Ziberi.

Në takim, drejtori Sela i dorëzoi Avokatit të Popullit kompletin e botimeve të publikuara nga AZGJ-ja, ndërsa e informoi edhe për projektet të cilat janë në vijim, si edhe projektet e planifikuara për të ardhmen nga AZGJ-ja.



Avokati i Popullit, si organ që i promovon dhe i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, shërben si shembull për zbatimin dinjitoz të Ligjit të Zbatimit të Gjuhëve. Megjithatë në praktikë ekzistojnë situata në të cilat qytetarët përballen me sfida në pjesën e realizimit të të drejtave të tyre në gjuhët zyrtare dhe në atë pjesë është i nevojshëm veprim i përbashkët i

institucioneve kompetente, me qëllim mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave qytetare.

Të dyja palët u angazhuan për vazhdimin e bashkëpunimit të shkëlqyer dhe ruajtjen e dialogut për çështje të interesit të përbashkët.

9 qershor 2021

Ligjërata të profesorëve Mustafa Ibrahimi dhe Qemal Murati

Institucion si AZGJ-ja do të duhej të kishin edhe Kosova edhe Shqipëria

Profesorët Mustafa Ibrahimi me temën "Përkthimi i teksteve të veçanta sociologjike dhe kulturore" dhe Qemal Murati me temën "Përkthimi i teksteve për artet dhe shkencat humane", janë ligjëruesit e radhës në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të administratës shtetërore që organizohet nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës.

Tema që trajtoj ka një rëndësi të veçantë për përkthyesit, sepse dukuritë sociolinguistike janë mjaft të pranishme në çdo tekst. Sociolinguistika, që paraqet raportin e gjuhës me shoqërinë ose anasjelltas, është mjaft aktuale në komunikim dhe shkrim, thotë prof. dr. Mustafa Ibrahimi, i cili shton se gjatë ligjëratave trajtohen edhe disa nëntema si globalizmi përballë gjuhëve, shtresimet e gjuhëve, planifikimi i gjuhëve si dhe kriteret për mbrojtjen e gjuhës standarde. Si çështje përkthimi u përmendën perifrazat, përkthimet e toponimeve binjake, përkthimet e zhargoneve dhe blendeve etj.

Ai e përshëndet iniciativën e agjencisë, për të organizuar këto trajnime, të cilat i konsideron si shumë të qëlluara, sepse kanë një rëndësi të veçantë për profesionalizimin në fusha të ndryshme dhe këto duhet të vazhdojnë.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, për një kohë shumë të shkurtër arriti të strukturohet dhe të bëjë hartimin e planifikimit për veprimin profesional në mbrojtjen e gjuhës shqipe nëpër institucione dhe përkthimin cilësor të teksteve" thotë në fund prof. dr. Mustafa Ibrahimi.



Është për t'u përshëndetur aktiviteti që zhvillon kjo agjenci me trajnimet për lektorë e përkthyes me një intenstitet të konsiderueshëm, për çka ka interesim nga punonjës në institucione të ndryshme, që të marrin dije dhe ta perfeksionojnë edhe më shumë gjuhën, në mënyrë që tekstet të dalin me sa më pak gabime, thotë prof. dr. Qemal Murati. Ai shton se "Sigurisht që nuk mund të pretendojmë që të kemi tekste pa gabime, sepse kjo është e paarritshme. Edhe unë në bashkëbisedim me ta, si pedagog ose si referues i disa problematikave, i shtrojmë disa probleme që t'i zgjidhim shkallë – shkallë, sepse nuk mundet me një të rënë të lapsit.

Gjuha është kulturë, por dhe çkulturë, gjuha të jep identitet nacional, kulturor dhe qytetërimor. Nëse e flasim gjuhën, kemi identitet qytetërimor, por nëse e flasim gjuhën përplot gabime siç e kemi në gjendjen e sotme, atëherë ky është një element që na degradon. Sot kemi një gjuhë standarde, por në praktikë, në medie, mund të themi se e kemi përtokë, prandaj dhe duhet të krijohen institucione për mirëmbajtjen e standardit të saj. Një rol të tillë, fatmirësisht, e ka marrë Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, krijuar para disa vitesh, e udhëhequr nga drejtori me kontribute të shquara, Ylber Sela, thotë prof. dr. Qemal Murati, duke theksuar se një agjenci të tillë do të duhej ta kishim edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri.

Trajnimi i organizuar nga AZGJ-ja tashmë ka hyrë në javën e pestë dhe në të janë përfshirë mbi 60 të punësuar nga institucione të ndryshme dhe do të përfundojë në javën e parë të korrikut.

14 qershor 2021

Botime me vlerë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - dhuratë për AZGJ-në

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, z. Ylber Sela priti sot prof. dr. Valter Memishën, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), si dhe kryetar i Komisionit të Përhershëm të Gjuhës dhe të Letërsisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, i cili, ditëve në vijim, është njëri nga ligjëruesit në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të administratës shtetërore.

Gjatë takimit të përzemërt, drejtori Sela dhe prof. dr. Valter Memisha folën për shumë probleme të gjuhësisë dhe të përdorimit të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, në të gjitha fushat, mes tjerash edhe në administratën shtetërore. Me këtë rast, mysafiri nga Tirana i dhuroi Agjencisë botimet leksikografike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të viteve të fundit: Fjalorin e gjuhës shqipe, 2006, me 48.000 fjalë, me 5000 njësi frazeologjike dhe 120.000 kuptime; Fjalorin e gjuhës shqipe, 2020, me 35.000 fjalë dhe 3000 njësi frazeologjike, një vepër që i kushtohet së shumti ligjërimit të shkollarëve të sistemit parauniversitar, por edhe ligjërimit studentor; Fjalorin e gjuhës shqipe të Aleksandër Xhuvanit, një vepër e përgatitur nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në bazë të fjalëve dhe të kuptimeve që kishte mbledhur dhe regjistruar profesor Xhuvani gjatë jetës së tij, por që nuk mundi t'i përpunonte leksikografsht dhe të hartonte një fjalor. Vepra ka 17.000 fjalë dhe 1500 njësi frazeologjike.





Po kështu, prof. dr. Memisha i dhuroi Agjencisë edhe Gramatikën historike të gjuhës shqipe të akademikut Kolec Topalli, e cila ecën në linjën e Gramatikës historike, të hartuar nga akademiku Shaban Demiraj, por që sjell dhe prurje të reja që e pasurojnë këndvështrimin shkencor, si dhe risi në studimet e strukturës gramatikore të shqipes në zhvillimin e saj historik.

Dhuratë me vlerë janë edhe veprat e akademikut Jani Thomai, “Studime për gjuhën shqipe”, në pesë vëllime, ku janë përfshirë artikuj studimorë që i përkasin leksikologjisë, semantikës leksikore, leksikografisë, dialektologjisë, kulturës së gjuhës etj.

14 qershor 2021

Vizitë pune e zëvendësdrejtorit të Shtëpisë Edukative Përmirësuese të Tetovës, në AZGJ

Zëvendësdrejtori i Shtëpisë Edukative Përmirësuese të Tetovës (SHEPT), Jusuf Shaini realizoi vizitë pune në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), ku u prit nga drejtori Ylber Sela.



Kjo vizitë shërbeu që të dyja institucionet të vendosin urë komunikimi për bashkëpunim të mëtejshëm.

Interesimi i përbashkët është zbatimi i dispozitave ligjore që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve. Prandaj, zëvendësdrejtori Shaini kërkoi mbështetje dhe udhëzime konkrete që ky ligj të zbatohet edhe në SHEPT. Ai i pranoi edhe botimet e AZGJ-së që kanë të bëjnë me këtë çështje.

Palët u dakorduan që të thellojnë bashkëpunimin dypalësh.

14 qershor 2021

Vizitë pune te Agjencia Nacionale e Programeve Arsimore Europiane dhe e Lëvizshmërisë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela realizoi një vizitë pune te Agjencia Nacionale e Programeve Arsimore Europiane dhe e Lëvizshmërisë (ANPAEL), ku u prit nga drejtori Marko Gjorgievski.

Nga kjo vizitë u kuptua se në këtë institucion kishte ngecje në zbatimin e dispozitave ligjore që burojnë nga Ligji i Përdorimit të Gjuhëve.



Drejtori Sela ofroi ndihmën konkrete të AZGJ-së në përkthimin dhe lekturimin e formularëve të ndryshëm që ANPAEL-i i ka në përdorim. Drejtori Gjorgievski pranoi botimet e AZGJ-së, të cilat ndihmojnë zbatimin e ligjit të lartpërmendur.

Palët u dakorduan që të thellojnë bashkëpunimin dypalësh.

15 qershor 2021

Drejtori i AZGJ-së Ylber Sela – në shënimin e 5-vjetorit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Në hollin e Bibliotekës Nacionale Universitare "Shën Klementi i Ohrit" në Shkup, sot Universiteti "Nënë Tereza" e shënoi 5-vjetorin e vet, duke zhvilluar një aktivitet kulturor, përkatësisht duke promovuar disa nga botimet e veta.

Para të pranishmëve foli rektori i këtij universiteti, prof. dr. Azis Pollozhani, si dhe disa personalitete të tjera. Pjesëmarrësit i përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela i cili ua uroi përvjetorin përfaqësuesve të Universitetit "Nënë Tereza", duke theksuar edhe disa mundësi dhe aspekte te bashkëpunimit të ndërsjellë. Me këtë rast ai e vuri në dukje edhe punën e AZGJ-së që po bën në zbatimin e gjuhës shqipe në nivele zyrtare.





16 qershor 2021

Shefi i Misionit të OSBE-së në Shkup, ambasadori Klemens Koja vizitoi AZGJ-në

Ambasadori Klemens Koja, shef i Misionit të OSBE-së në Shkup, i shoqëruar nga Katarina Zhivkoviq, asistente nacionale programore, vizituan sot Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), ku u pritën nga drejtori Ylber Sela dhe këshilltari Lirim Shabani.



Me këtë rast, drejtori Sela e njoftoi ambasadorin Koja për aktivitetet e deritanishme të kësaj agjencie, duke theksuar bashkëpunimin dypalësh me OSBE-në.

Si fryt i këtij bashkëpunimi të vazhdueshëm është mbështetja e botimit të Manualit – Program trajnimi për përkthim dhe interpretim maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht dhe lektorë të shqipes.

Ambasadori Koja u shpërndau manualin përkthyesve dhe lektorëve të institucioneve publike që janë përfshirë në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve që organizohet nga AZGJ-ja.

Në këtë takim u rikonfirmua bashkëpunimi dypalësh dhe gatishmëria e përgatitjes së projekteve të ardhshme të përbashkëta.

17 qershor 2021

Ligjërata të profesorëve Valter Memisha dhe Izer Maksuti për leksikografinë dhe përkthimin e teksteve shkencore

Këtë javë, trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve të administratës ka vazhduar me profesorët Valter Memisha dhe Izer Maksuti, i pari me ligjërata për rolin që ka leksikografia në procesin e përkthimit, ndërkaq i dyti është përqendruar në përkthimin e teksteve të specializuara dhe shkencore.

Që të dy e vlerësojnë lartë këtë aktivitet, por dhe të gjitha aktivitetet që ka ndërmarrë Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që nga themelimi i saj e deri sot, si meritë e drejtorit Ylber Selës me stafin profesional.

"Më vjen mirë që Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e ka ngritur nivelin e punës së vet në tri shtylla kryesore: në të parën, shkuarja tek librat, veprat shkencore që lidhen me shqipen në përgjithësi dhe shqipen standarde në veçanti. Shtylla e dytë është organizimi i veprimtarive shkencore, sidomos të konferencave në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke synuar dhe realizuar ardhjen e mendimit shkencor më të pjekur, më të konsoliduar dhe më të frytshëm për mbarëvajtjen e gjithë punës dhe synimeve që i ka vendosur kjo agjenci. Dhe së treti, ku jam përfshirë edhe unë për momentin, është kualifikimi i punonjësve të administratës", thotë prof. dr. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), si dhe kryetar i Komisionit të Përhershëm të Gjuhës dhe të Letërsisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Edhe prof. dr. Izer Maksuti vë në dukje rolin e jashtëzakonshëm të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke u bërë një institucion i njohur në vend dhe në të gjitha qendrat tjera albanologjike, e duke bashkëpunuar me studiuesit më të njohur në vend dhe në hapësirat shqiptare e më gjerë.

Lidhur me trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve Maksuti thotë se është një dhuratë shtesë nga Agjencia, sepse këtu trajtohen tema nga më të ndryshmet, u ofrohet material, mësim dhe përvojë nga studiues të gjuhës, që janë vendimtare në procesin e përkthimit.

Prof. Izer Maksuti thotë se në zbatimin ligjit, vendimtar është vullneti politik, por në anën tjetër edhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, duke qenë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm për shkrimin e gjuhës shqipe krahas maqedonishtes.

Në qoftë se e përdorim ne shqipen në mbarë vendin, nëse shqipja është në institucione, atëherë janë edhe shqiptarët. Roli identitar i përdorimit të gjuhës shqipe në institucione është vendimtar për shqiptarët e Maqedonisë, vë në dukje prof. dr. Izer Maksuti.

Trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve vazhdon edhe për disa javë.





22 qershor 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela – në Javën e Albanologjisë në Prishtinë

Dje në Institutin Albanologjik të Prishtinës u hap Java e Albanologjisë, e 12-ta me radhë, ku të pranishmit i përshëndeti drejtori i këtij institucioni dr. Hysen Matoshi, i cili u uroi mirëseardhje dhe punë të mbarë. Po ashtu, pjesëmarrësit i përshëndeti edhe ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit të Republikës së Kosovës, Arbërie Nagavci.

Në këtë aktivitet shkencor e kulturor që do të zhvillohet deri më 23 qershor dhe ku do të trajtohen aspekte të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e terminologjisë në gjuhën shqipe, si dhe shumë çështje të tjera të fushës albanologjike, me ftesë të organizatorit mori pjesë edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i shoqëruar edhe nga përgjegjësi i Sektorit të përkthimit dhe lekturës, Ahmet Selmani. Drejtori Sela zhvilloi takime të shumta me personalitete të jetës shkencore e shoqërore dhe me studiues të ndryshëm të albanologjisë.

Me këtë rast për bibliotekën e AZGJ-së, atij ia dhuruan edhe disa nga botimet më të reja të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Po ashtu, drejtori Y. Sela vizitoi edhe Institutin e Studimeve Sociale dhe Humanistike, ku u takua me drejtorin e saj, Arsim Sinani, si dhe profesorët e Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli dhe Selim Bezeraj. Gjatë këtij takimi u bisedua lidhur me bashkëpunimin ndërmjet institutit në fjalë dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Me këtë rast drejtori Sinani i dhuroi disa botime të institutit të tij.





24 qershor 2021

Profesorët Adnan Jashari dhe Afet Mamuti mbajtën ligjërata për terminologjinë juridike

Dy ligjëruesit e radhës në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të institucioneve shtetërore, profesorët Adnan Jashari dhe Afet Mamuti, u paraqitën para përkthyesve dhe lektorëve me temën e terminologjisë juridike në dokumentet zyrtare dhe aktet ligjore. Sipas tyre, duhet bërë përpjekje maksimale që terminologjia që përdoret në institucionet publike të jetë sa më e unifikuar. Që të dy vënë në dukje rëndësinë e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe rolin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës në ngritjen e cilësisë së përdorimit dhe të statusit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedoninë e Veriut.

Prof. dr. Adnan Jashari, ligjërues në Universitetin e Europës Juglindore, trajtoi temën e terminologjisë juridike të korrespodencës ekonomike, të afarizmit dhe të kontratave dhe shprehu kënaqësinë dhe entuziazmin për arritjet e deritashme, ndonëse siç thotë ai, ka edhe shumë punë për të bërë.





- Me qëllim që në të ardhmen të arrijmë që të bëjmë unifikimin e terminologjisë gjatë përkthimeve të akteve të ndryshme, si ato ligjore, si ato administrative, gjyqësore, apo shkresave të ndryshme, në një farë mënyre të përforcohet dhe të koordinohet lidhshmëria midis përkthyesve dhe Agjencisë në njërën anë, dhe Agjencisë dhe ekspertëve nga sfera të ndryshme, në anën tjetër, thotë profesori Adnan Jashari.

Sipas tij, e gjithë kjo do të krijojë parakushte që përkthimet e vendimeve, të ligjeve, dhe të akteve të tjera zyrtare, të unifikohen në aspekt terminologjik. Më tej, ai vlerësoi edhe kontributin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe të drejtorit Ylber Sela, nëpërmjet aktiviteteve dhe botimeve të shumta, e sidomos nëpërmjet trajnimit të përkthyesve të lektorëve të institucioneve publike.

Edhe prof. dr. Afet Mamuti, ligjërues në Universitetin e Tetovës, trajtoi temë të ngjashme, atë të përkthimit të terminologjisë juridike në ligje.

Prof. Ylber Sela ka bërë një punë mjaft të mirë, veçanërisht me aktivitetet që po organizon, siç është edhe ky i fundit, me trajnimin e përkthyesve nga të gjitha institucionet, duke nisur nga kryeministria, nga ministritë, drejtoritë, agjencitë e ndryshme, ku për disa ditë radhazi na u dha mundësia që t'i diskutojmë disa çështje, veçanërisht që kanë të bëjnë me përkthimin e akteve normative.

Diskutimet që i kishim me kandidatët, ishin mjaft produktive dhe temat që i prekëm besoj se do të jenë një ndihmesë e madhe me rastin e përkthimit të dokumenteve, që kur të merr qytetari të lexojë aktin normativ, të përdoret terminologji e njëjtë, e qartë, e saktë dhe të mos ketë dykuptimësi, thotë profesori Afet Mamuti.

Ai thotë se pas nxjerrjes së Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, statusi i gjuhës shqipe pësoi një ndryshim rrënjësor në pikëpamje të avancimit të përdorimit të saj, çfarë nuk e kishte para këtij ligji. Këtë e ndihmoi veçanërisht krijimi i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, e cila vendosi komunikimin me Tiranën dhe Prishtinën zyrtare "për të bërë unifikimin dhe standardizimin e disa termeve që duhej të bëjnë të punësuarit nga kjo agjenci dhe se pas gjithë këtyre aktiviteteve, shumë më lehtë do të jetë në të ardhmen.

24 qershor 2021

Takim pune me drejtorin e Kopshtit Zoologjik të Shkupit

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, dr. Ylber Sela, së bashku me udhëheqësin e Sektorit të planifikimit, të koordinimit dhe të zhvillimit, dr. Marjan Patlixhankovski, realizoi sot takim me drejtorin e Kopshtit Zoologjik të Shkupit, z. Gjorgji Galetanovski. Në takim u fol për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Kopshtin Zoologjik, Shkup.

Gjatë takimit me z. Galetanovski kuptuam se në Parkun Dino të ri zbatohet plotësisht përdorimi i të dy gjuhëve zyrtare të RMV-së.





Tabelat e informimit dhe njoftimit të qytetarëve në Kopshtin Zoologjik nuk janë të përkthyera në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, mirëpo gjatë skenimit të çdo kodi QR të secilës kafshë të ekspozuar, shfaqet përkthimi dhe përshkrimi me zë i kafshës në gjuhën shqipe.

Drejtori i Agjencisë, dr. Ylber Sela ofroi bashkëpunim dhe ndihmë për përkthimin dhe lekturimin e të gjitha tabelave të informimit të qytetarëve, ndërkaq drejtori Galetanovski shprehu kënaqësi për bashkëpunimin e ofruar.

29 qershor 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela u takua me drejtoreshën e Bibliotekës "Vëllezërit Milladinov" në Shkup

Në suaza të vizitave të zakonshme, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot zhvilloi një takim zyrtar me Suzana Danaillovën, drejtoreshë e Bibliotekës së qytetit "Vëllezërit Milladinov" në Shkup. Me këtë rast ai e njoftoi homologen e tij lidhur me punën që po bën AZGJ-ja duke i ndihmuar institucionet shtetërore për ta zbatuar Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, përkatësisht përdorimit të gjuhës shqipe. Në suaza të kësaj, ai theksoi se duhet të vendoset një bashkëpunim konkret mes këtyre dy institucioneve, duke i ofruar ndihmë në aspektin e përkthimit dhe lekturimit të tabelave, akteve, shkresave, formularëve etj. Veçmas ai e vuri në spikamë çështjen e librezave të anëtarësisë në këtë bibliotekë të cilat tani janë vetëm në një gjuhë.



Nga ana tjetër, drejtoresha Suzana Danailova theksoi se kjo bibliotekë punon sipas sistemit COBIS me të cilin janë të lidhur, prandaj librezat në një gjuhë janë të vjetra, por librezat e reja që do t'i bëjmë tani e tutje do të jenë në dy gjuhë. Për sa i përket përkthimit në këtë institucion, ajo theksoi se janë të punësuar njerëz adekuat të cilët po e kryejnë mirë punën e tyre. Por, shtoi më tej ajo, nëse na shfaqet nevoja për ndonjë ndihmë rreth përkthimit, atëherë gjithsesi do ta kërkojmë këtë nga ana e agjencisë suaj.

30 qershor 2021

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela mori pjesë në ceremoninë solemne të gjeneratës së tretë të absolventëve të Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, organizuar në sheshin "Skënderbej"

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela mori pjesë në ceremoninë solemne të gjeneratës së tretë të apsolventëve të Universitetit 'Nënë Tereza' në Shkup, organizuar në sheshin "Skënderbej". Ata kurorëzuan mundin katërvjeçar, me hedhjen e kapelave, që simbolizon mbarimin e ligjeratave në pesë fakultetet e universitetit të vetëm publik në gjuhën shqipe në kryeqytet.



9 korrik 2021

Përfundoi trajnimi i përkthyesve dhe i lektorëve

Pas dy muajsh program të ngjeshur, të mërkurën, 7 korrik, përfundoi trajnimi i lektorëve dhe i përkthyesve të administratës nën organizimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Në programin dymujor të trajnimeve, morën pjesë 68 përkthyes dhe lektorë nga 31 institucione të ndryshme të administratës, të cilëve në shtator të këtij viti Agjencia e Zbatimit të Gjuhës do t'u ndajë certifikata.

Ligjëruesit e fundit ishin profesori i njohur nga Shqipëria, dr. Emil Lafe, i cili trajtoi çështjet drejtshkrimore dhe pastërtinë e gjuhës dhe prof. dr. Ajten Hajdari Qamili, e cila pjesëmarrësve u ligjëroi për analizë teksti.



Krijimi i AZGJ-së dhe nisja e mbarë e veprimtarisë së saj përbën një ngjarje me rëndësi të veçantë jo vetëm për jetën kulturoro-shkencore e shoqërore të shqiptarëve në RMV, por edhe për kulturën dhe jetën mendore e shoqërore shqiptare në tërësi. Inteligjencia shqiptare në RMV me mbështetjen edhe të faktorit politik shqiptar, ka shënuar përparime domethënëse, veçanërisht në fushën e studimeve albanologjike, të kulturës, të letërsisë dhe të arteve, thotë prof. Emil Lafe, i cili ligjëratën e tij me tri grupet e trajnimit e mbajti onllajn, nga Tirana. Ai konsideron se të gjitha këto çojnë te vlerësimi i gjuhës standarde shqipe, si një mjet dhe faktor i dorës së parë për zhvillimin e mëtejshëm cilësor të jetës shoqërore e kulturore të shqiptarëve në RMV, duke i dhënë asaj një vend gjithnjë e më të spikatur në kulturën tonë kombëtare.

Së bashku me kolegët e tjerë të Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare e kemi mirëpritur ftesën e AZGJ-së për bashkëpunim dhe do të jemi gjithnjë të gatshëm

të japim ndihmesën tonë në mbarëvajtjen dhe përmbushjen e programit të saj. Pjesëmarrja jonë në konferencën "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV" (shkurt 2020), na dha mundësi të njohim nga afër detyrat dhe synimet e AZGJ-së, si edhe të vërejmë te punonjësit e saj një ndjenjë të lartë përgjegjësie dhe përkushtimi ndaj detyrës. Ne do të jemi gjithnjë së bashku me ju, sepse detyra juaj është edhe detyra jonë, suksesi juaj është edhe suksesi ynë, thekson prof. Emil Lafe në vlerësimet e tij për trajnimet dhe aktivitetet që AZGJ-ja ka ndërmarrë deri më tash.

Trajnimet e këtilla, siç vë në dukje profesoresha Ajten Hajdari Qamili, kanë qenë ndër misionet kryesore të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës dhe që do të vazhdojë edhe viteve të ardhshme, varësisht nga nevojat, pasi dihet se ka mungesë të cilësisë dhe mungesë të kuadrit në institucione.

Në bazë të kësaj do të bëhet përforcimi i nivelit të përkthyesve dhe lektorëve nëpër institucione, duke marrë profesorë nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe nga Kosova, që sjellin përvoja të ndryshme. Ne në këto trajnime, përveçse kemi diskutuar çështje që krijojnë mëdyshje te përkthyesit gjatë punës së tyre ose në terren, njëkohësisht bëjmë edhe marrëveshje kolegjiale me gjuhëtarët nga vendi dhe jashtë, për të njëjtësuar terminologjinë administrative në ato vende ku ka mundësi të bëhet kjo, kurse për më tutje do të ketë edhe kongrese a seminare të tjera me qëllim të njëjtësimit të terminologjisë administrative - shprehet prof. A. H. Qamili.

Ajo paralajmëroi edhe modifikime të profesionalizimit të përkthyesve dhe të lektorëve, duke filluar në grupe sikur sivjet, e më pas në ndonjë grup të përbashkët, që të mund mes vete të kenë komunikim për t'i këmbyer përvojat e tyre, për t'i diskutuar çështjet që kanë mëdyshje, për të rritur cilësinë e përkthimeve dhe zbatimin e gjuhës shqipe në të gjitha institucionet shtetërore.

Gjatë këtij cikli trajnues, pjesëmarrësit kishin rast të dëgjojnë ligjërata nga gjuhëtarët më të njohur nga qendrat universitare të Maqedonisë së Veriut, të Shqipërisë dhe të Kosovës, të cilët trajtuan probleme të shumta që dalin nga përdorimi i gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera zyrtare në administratë. Çështja e terminologjisë dhe e njësimit të saj si nevojë, ndikimet e gjuhëve te njëra-tjetra, leksikografia, semiotika, ndikimet në sintaksë dhe një varg problemesh tjera, ishin objekt trajtimi nga profesorët Emil Lafe, Asllan Hamiti, Ismet Osmani, Valter Memisha, Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Berton Sulejmani, Ajtene Hajdari Qamili, Xhelal Zejneli, Afet Mamuti, Qemal Murati, Izer Maksuti, Zeqirja Ibrahimi, Adnan Jashari dhe Mustafa Ibrahimi.

14 korrik 2021

Takim njoftues me UNOPS-in në RMV

Në kuadër të aktiviteteve të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) për të bashkëpunuar me organizata të ndryshme, drejtori i saj, Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, realizuan një takim njoftues me Zyrën e OKB-së për Shërbime Projekti (UNOPS) në RMV.



Me këtë rast, menaxherja e projektit, Sherife Ismaili Kasapi dhe bashkëpunëtori i projektit, Igor Markovski informuan rreth aktiviteteve dhe fushëveprimit të UNOPS-it në RMV. Nga ana tjetër, drejtori Sela, i njoftoi nikoqirët për punën, veprimtarinë dhe detyrimet ligjore që i ka AZGJ-ja, për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Në këtë takim, u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Palët u dakorduan që të komunikojnë me njëra-tjetrën për projekte të interesit të përbashkët.

16 korrik 2021

Drejtori Sela realizoi takime të rëndësishme në Tiranë

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela realizoi një vizitë në Tiranë ku u takua me Dorian Koçin, drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, me te cilin ranë dakord që të zhvillojnë dy aktivitete në muajt shtator dhe nëntor.

Ata këmbyen edhe ide për projekte të tjera për vitin 2022.





Gjithashtu, drejtori Sela takoi edhe Mimoza Hysën me të cilën biseduan për punën dhe aktivitetet e të dyja institucioneve, duke shikuar pikat e përbashkëta për bashkëpunim në të ardhmen rreth botimeve dygjuhësore dhe aktiviteteve të tjera.

26 korrik 2021

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës ndihmon Akademinë e Gjykatësve dhe të Prokurërove Publikë për përkthimin dhe lekturimin e akteve të brendshme

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot e priti zëvendësdrejtorin e Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve, Ilir Isenin, ku biseduan për bashkëpunimin midis këtyre dy institucioneve në fushën e përdorimit të gjuhëve zyrtare.



Më konkretisht, drejtori Ylber Sela, i premtoi përkrahje Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë për përkthimin dhe lekturimin e akteve të brendshme të saj, duke pasur parasysh se nuk kanë persona të angazhuar me kualifikim përkatës.

Zëvendësdrejtorit të AGJP-së, Ilir Isenit, drejtori Sela ia dhuroi edhe botimet e AZGJ-së, që janë ndihmesë në zbatimin praktik të gjuhëve në administratë dhe gjithë sektorin publik.

28 korrik 2021

Konsultime me Agjencinë e Planifikimit të Hapësirës, në lidhje me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, realizoi takim konsultues me Andrijana Andreeva, drejtoreshë e Agjencisë së Planifikimit të Hapësirës (APH).

Temë e takimit ishte zbatimi i dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve edhe në këtë institucion.

Drejtoresha Andreeva shprehu gatishmërinë që të veprohet konkretisht në drejtim të këtij qëllimi dhe theksoi rëndësinë e aspektit terminologjik specifik për këtë sferë.



Nga ana tjetër, drejtori Sela shprehu rëndësinë e fillimit të përdorimit të gjuhës shqipe në shkresat dhe dokumentet e tjera të këtij institucioni, duke ofruar mbështetje konkrete në përkthim dhe lekturë.

Dy homologët u dakorduan që bashkëpunimi institucional të zhvillohet në frymën e mirëkuptimit dhe të mbështetjes ndërinstitucionale.

29 korrik 2021

Bashkëpunim ndërinstitucional me Gjykatën Supreme me temë zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela realizoi një takim bashkërendues në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u prit nga kryetarja e gjykatës, Besa Ademi.
Në këtë takim u diskutua për dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe mënyrat më të lehta të zbatimit të tyre nga gjykatat e vendit.



Me këtë rast, kryetarja Ademi kërkoi sqarime plotësuese dhe mbështetje të drejtpërdrejtë në spektin e zbatimit të ligjit në fjalë edhe në Gjykatën Supreme.

Nga ana tjetër, drejtori Sela ofroi mbështetjen e plotë të AZGJ-së me ato kapacitete që i ka.

Sela dhe Ademi u dakorduan që ky takim të jetë pikënisja e hapave konkretë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Gjykatën Supreme.

30 korrik 2021

AZGJ-ja dhe MSPMB-ja ndanë certifikata për 65 pjesëmarrësit në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të institucioneve publike

Sot Agjencia e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) dhe Ministria e Sistemit Politik dhe e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive (MSPMB) ndanë certifikata për 65 pjesëmarrësit që morën pjesë në trajnimin e përkthyesve dhe të lektorëve të institucioneve që u mbajt nga 6 maji deri më 7 korrik të këtij viti.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së RMV-së dhe ministri i Sistemit Politik dhe i Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Mila Carovska dhe përfaqësues të institucioneve të tjera.

Gjuha dhe e drejta për ta përdorur është një nga katër shtyllat e Marrëveshjes së Ohrit, tha midis tjerash zëvendëskryeministri Artan Grubi, në fjalën e tij të rastit, duke shtuar se prej kësaj marrëveshje askush nuk humbi, porse kanë fituan qytetarët dhe shteti.

Sipas tij, gjuha u bë pjesë normative e Kushtetutës vetëm nëpërmjet Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe zgjati dy dekada deri në përmbylljen e avancimit të përdorimit në institucionet publike, duke shtuar se me këtë qytetarët bëhen më besnikë ndaj shtetit dhe anasjelltas.

Unë e përsëris gjithnjë, sa më besnik të jetë shteti ndaj një komuniteti, aq ai komunitet është besnik ndaj shtetit. Dhe sot ne shqiptarët, edhe qytetarët e tjerë, jemi më besnikë ndaj shtetit, shtoi Grubi.

Grubi theksoi se Ligji i Përdorimit të Gjuhëve nuk rregullon vetëm përdorimin e gjuhës shqipe, por jep mundësi të përdorimit edhe të gjuhëve të komuniteteve të tjera në komunat ku përbëjnë më shumë se 20 për qind, dhe se përfitues nuk janë vetëm maqedonasit dhe shqiptarët.

Ministrja e Arsimit dhe e Shkencës, Milla Carovska, në fjalën e saj përshëndetëse u ndal te reformat në arsimin fillor, që krijojnë mundësi që të gjithë të mësojnë gjuhën e vet, por njëkohësisht edhe të njihen edhe me gjuhën dhe kulturën e tjetrit. Duke iu drejtuar përkthyesve dhe lektorëve që sot morën certifikatat, ajo ua bëri me dije se përgjegjësia për librat shkollorë për klasat e ulëta do të bie mbi ta.





Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela i ndau ABC-në zëvendëskryeministrit të parë, Artan Grubit, për kontributin e tij dhe të Qeverisë në krijimin e kushteve hapësinore dhe të punës. Ai në fjalën e tij të rastit, u apeloi institucioneve shtetërore e arsimore, para se gjithash Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe tri universiteteve (Cirili e Metodi, UEJL-së dhe UT-së) që të nxisin profesionalizmin e kuadrove të nevojshme për zbatimin e gjuhëve në administratë, duke dhënë bursa, kurse edhe kësaj radhe e përsëriti nevojën që përkthyesve t'u rritet statusi nga punëtorë administrativë, në punëtorë profesionalë, duke pasur parasysh natyrën e punës dhe përgjegjësinë e madhe që kanë.

Ky aktivitet i mbajt në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Në trajnimin e sivjetmë morën pjesë 65 përkthyes e lektorë nga 31 institucione dhe morën pjesë 15 profesorë nga Maqedonia e Veriut, Shqipërisë dhe Kosovës.

10 gusht 2021

Vizitë e zëvendësambasadorit të Francës në AZGJ

Sot, më 10 gusht 2021, ushtruesi i detyrës zëvendësambasador i Francës në Maqedoninë e Veriut, Stanislas Mrozek, i shoqëruar nga përkthyesi i ambasadës në gjuhën shqipe dhe përgjegjësi i protokollit, Ardian Ramadani, si dhe stazhieri pranë kësaj ambasade, Emilien Kientz, vizituan për herë të parë hapësirat e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, me ç'rast u takuan me drejtorin e agjencisë, Ylber Selën.

Takimi, i cili u zhvillua në frymë tejet miqësore, ishte një mundësi e mirë për të këmbyer mendime dhe përvoja rreth pistave të mundshme të bashkëpunimit mes Ambasadës së Francës në RMV, Institutit Francez në Shkup dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës.

Drejtori Sela, pasi prezantoi në hollësi agjencinë që drejton, shtjelloi edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet ky institucion, si dhe sukseset, rezultatet dhe përparimin e arritur deri më tani, agjenci kjo e cila shërben si kujdestare për mënjanimin e gabimeve në gjuhën shqipe, si dhe gjuhët e tjera.

Ai përmendi edhe trajnimet e realizuara të përkthyesve dhe të lektorëve, duke e dalluar agjencinë si një institucion lider dhe shëmbëlltyrë.

Drejtori Sela vuri në pah bashkëpunimin e kësaj agjencie me institucionet e tjera në këtë vend, duke uruar që ky bashkëpunim të thellohet edhe më shumë.





Bashkëbiseduesit mes tjerash folën edhe rreth mundësive për realizimin e vizitave në qendra të njohura gjuhësore në Europë dhe në Francë, si dhe rreth mundësive për vizitë të ekspertëve gjuhësorë nga Franca në këtë agjenci, me qëllim të sjelljes së përvojës dhe ekspertizës së tyre dhe shkëmbimit të ndërsjellë.

Ata u dakorduan edhe për mundësinë e nisjes së projektit të bashkëpunimit në fushën e përkthimit, të gjuhëtarëve të shquar francezë, në gjuhën shqipe, si dhe në atë maqedonase.

Zëvendësambasadori Mrozek e siguroi drejtorin Sela se bashkëpunimi mes ambasadës dhe agjencisë do të thellohet më tutje, duke premtuar përkrahje konkrete dhe të vazhdueshme të veprimtarisë së kësaj agjencie në fushën e përkthimit dhe të interpretimit.

12 gusht 2021

Nis bashkëpunimi mes Agjencisë së Mbështetjes Financiare të Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela sot priti në takim zëvendësdrejtorin e Agjencisë së Mbështetjes Financiare të Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural, Remzi Abdullahin dhe bashkëpunëtorët e tij .

Në këtë takim u diskutua për shkallën e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës Shqipe në këtë institucion dhe mënyrat më të lehta për zbatimin e tij, për të qenë më afër këtij komuniteti.

Me këtë rast, zëvendësdrejtori Abdullahi kërkoi sqarime shtesë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për zbatimin e ligjit në Agjencinë e Mbështetjes Financiare të Bujqësisë, ndërkaq drejtori Sela ofroi mbështetje të plotë të AZGJ-së në përkthimin e akteve, të shkresave dhe të formularëve me ato kapacitete që zotëron.



Të dy bashkëbiseduesit u dakorduan që ky takim të jetë nismë e mbarë drejt hapave konkretë të zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në këtë institucion.

7 shtator 2021

Në AZGJ u promovua libri "Koha e ardhme e foljes në gjuhën shqipe" i autorit dr. Sejdi Gashi


Në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup sot u promovua libri "Koha e ardhme e foljes në gjuhën shqipe" i autorit dr. Sejdi Gashi.

Në fillim të këtij aktiviteti, të pranishmit në AZGJ, si dhe mysafirët nga Prishtina që ishin në linjë të drejtpërdrejtë, i përshëndeti drejtori Ylber Sela duke theksuar se dyert e institucionit të tij do të jenë përherë të hapura për bashkëpunime që janë në interes të gjuhës shqipe.

Për librin në fjalë folën studiuesit Begzat Balliu dhe Naim Berisha nga Prishtina, të cilët vunë në dukje vlerat shkencore të kësaj vepre.

Po ashtu, për librin "Koha e ardhme e foljes në gjuhën shqipe" foli edhe Ahmet Selmani, përgjegjës i Sektorit të përkthimit dhe të lekturës në AZGJ, i cili theksoi disa aspekte që e karakterizojnë këtë vepër.

Në diskutim u përfshirë edhe disa pjesëmarrës të tjerë dhe fjalën përfundimtare e pati vetë autori i librit, dr. Sejdi Gashi.


Република Северна Македонија
Агенција за примена на јазикот на РСМ
Republika e Maqedonisë së Veriut
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së
Promovimi i librit të Sejdi Gashit
Промоција на книгата на Сејди Гаши
KOHA E ARDHME
E FOLJES NË GJUHËN SHQIPE



13 shtator 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela zhvilloi takim pune me koordinatorin e TIKA-së

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , Ylber Sela, realizoi takim pune me z. Halim Omer Sogut, koordinator i programit të Agjencisë Turke të Bashkëpunimit dhe të Koordinimit – TIKA në Shkup.

Duke e faleminderuar për takimin, drejtori Sela e theksoi rolin e rëndësishëm që ka TIKA në aspektin e mbështetjes për projektet e sferave të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë rast ai e njoftoi bashkëbiseduesin e tij lidhur me punën e deritanishme të AZGJ-së. Në këtë kontekst, të dy përfaqësuesit patën mundësi për të shkëmbyer mendime për mbështetjen e mundshme nga TIKA për projektet prioritare që do të realizoheshin nga ana e AZGJ-së.



Të dyja palët e vlerësuan takimin si shumë të dobishëm duke theksuar se mundësitë mbeten të hapura për të vazhduar komunikimin dhe bashkëpunimin në projekte me interes të përbashkët.

14 shtator 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela takoi sekretarin e MPPS-së, Resmi Ejupi

Sot në AZGj qëndroi Resmi Ejupi, sekretar shtetëror në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale, i cili bashkë me kolegët e tij realizuan takim me drejtorin e AZGJ-së, Ylber Sela, për t'u konsultuar rreth disa çështjeve për sa i përket zbatimit të gjuhës shqipe në këtë ministri.

Gjatë këtij takimi, drejtori i AZGJ-së Ylber Sela dhe sekretari shtetëror Ejupi biseduan lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore, ndërkaq me këtë rast drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela i ofroi mbështetje të plotë dhe ndihmë nga shërbimet e AZGJ-së në aspektin e përkthimit dhe të lekturës së dokumenteve të nevojshme.



Bashkëbiseduesit u dakorduan për bashkëpunim të mëtejshëm mes dy institucioneve, në mënyrë që zbatimi i dispozitave të ligjit të jetë në nivelin e duhur në këtë institucion.

14 shtator 2021

AZGJ dhe MAPAS ranë dakord për bashkëpunim

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, realizoi takim pune me delegacionin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), të përfaqësuar nga Shpresa Rexhepi, këshilltare e burimeve njerëzore dhe Dionis Stratrov, udhëheqës i Njësisë së çështjeve administrative dhe furnizimeve publike.

Në takimin e punës u diskutua rreth situatës në lidhje me harmonizimin e punës së MAPAS-it me dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, mënyrën e bashkëpunimit rreth përkthimit të akteve nënligjore dhe formularëve zyrtarë, si dhe lekturimin e akteve të MAPAS-it të cilat shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".



Drejtori Sela shprehu gatishmëri që AZGJ-ja ta mbështetë punën e MAPAS-it si subjekt institucional që mbikëqyr funksionimin e fondeve të pensioneve me qëllimin përfundimtar për të mbrojtur interesat e anëtarëve të tyre, përkatësisht të siguruarit.

Të dyja palët ranë dakord se takimet e tilla janë reciprokisht të dobishme dhe se koordinimi në nivel ndërinstitucional do të vazhdojë në baza të rregullta.

23 shtator 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela vizitoi SHFK "Dimitar Miladinov", Komuna e Qendrës

Me ftesë të Shkollës Fillore Komunale "Dimitar Milladinov" nga Komuna e Qendrës, drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela mori pjesë në një aktivitet me të cilin kjo shkollë shënoi Ditën Europiane të Gjuhëve.

Drejtori Sela, së bashku me ambasadorin francez, shkëlqesia e tij, Siril Baumgartner, i cili gjithashtu ishte prezent në ngjarje, pati mundësinë të ndiqte programin e përgatitur nga shkolla e cila e feston simbolikën e Ditës Europiane të Gjuhëve, diversitetin gjuhësor dhe rëndësinë e zhvillimit të aftësisë shumëgjuhësore të nxënësve.

Duke e falënderuar për ftesën e dërguar nga drejtoresha e shkollës, zonja Marija Varsamis Simonovska, drejtori Sela theksoi se është veçanërisht i kënaqur që shkolla është e hapur për bashkëpunim me institucionet e tjera publike me kompetenca për zbatimin e politikave gjuhësore dhe se, në këtë aspekt, AZGJ-ja do të vazhdojë të mbështesë aktivitete të tilla që promovojnë vlera pozitive, zhvillimin e shumëgjuhësisë si mjet i dialogut ndërkulturor midis bashkësive, duke krijuar kështu një shoqëri gjithëpërfshirëse.





27 shtator 2021

Diversiteti gjuhësor kontribuon në kohezionin shoqëror

Me tryezën e rrumbullakët "Koncepti europian i diversitetit gjuhësor në realitetin e sotëm-gjendja dhe sfidat në Republikën e Maqedonisë së Veriut", Agjencia e Zbatimit të Gjuhës u përfshi në shënimin e 26 Shtatorit - Ditës Europiane të Gjuhëve, ku morën pjesë përfaqësues ambasadash të shteteve europiane dhe të institucioneve të vendit si dhe të sektorit joqeveritar.



Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, në fjalën përshëndetëse theksoi se respektimi i konceptit të diversitetit gjuhësor është veçanërisht i rëndësishëm në një shoqëri shumëkulturore, shumëgjuhësore që pa dyshim kontribuon në forcimin e mirëkuptimit reciprok midis etnive të ndryshme si dhe avancimin e kohezionit dhe veprimit ndëretnik. "Prandaj mendoj se ky koncept duhet të ruhet dhe të mirëmbahet vazhdimisht", tha drejtori Sela, duke përkujtuar se miratimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve më 2019 është një hap përpara në realizimin e përpjekjeve për forcimin e proceseve demokratike, garantimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve dhe avancimin e karakterit shumëgjuhësor të shoqërisë.

Anke Holshtajn (Anke Holstein), ambasadore e Republikës Federale të Gjermanisë, foli për përvojat e saj me situata që ka hasur duke qenë e angazhuar vite me radhë në Bruksel. Në lidhje me përdorimin e gjuhëve, ajo theksoi se në parimet dhe idetë e BE-së është diversiteti, uniteti dhe garantimi i përdorimit të gjuhës për secilin dhe mundësia për të pasur qasje në dokumentet zyrtare të BE-së edhe atë të përkthyera në të gjithë gjuhët që fliten në BE. Në këtë kontekst përmendi pozicionin që kanë gjuhët, anglishtja dhe frëngjishtja si kryesore në politikat e sigurisë, por dhe gjuhët e tjera më të vogla në kuadër të organeve të BE-së. Holshtajn foli për përkthimin si proces brenda BE-së dhe vështirësitë që ajo ka hasur gjatë punës së saj në institucionet e BE-së, si pjesë e delegacionit gjerman. Ajo u ndal edhe te përvojat gjermane, te gjuha zyrtare gjermane, gjuhët e minoriteteve dhe problemin e inkluzivitetit të emigrantëve të cilët në familjet e tyre vazhdojë të flasin vetëm gjuhën amtare, duke mos e mësuar atë gjermane. Sipas saj, kushdo që vjen në Gjermani dhe dëshiron që të jetojë aty, atëherë duhet ta mësojë edhe gjuhën gjermane.

Lusien Aegerter (Lucien Aegerter), zëvendësshef i Misionit dhe zëvendësshef i Bashkëpunimit në Ambasadën e Konfederatës Zvicerane në RMV, në fillim të fjalës së tij tha se shumëllojshmëria e gjuhëve është vlerë thelbësore e identitetit zviceran. "Zvicra dhe Maqedonia e Veriut kanë shumë të përbashkëta, të qenët shtete shumëgjuhëshe është në qendër të miqësisë sonë të fortë. Të dyja vendet e mbajnë lartë dhe e mbrojnë shumëllojshmërinë e gjuhëve, dhe si të tilla, dy shtetet tona kanë shumë të përbashkëta dhe mund të ndajnë pikëpamje dhe përvoja", tha ai. Më tutje ai përmendi gjuhët zyrtare në Zvicër, gjermanishten (63%), frëngjishten (23%), italishten (8%), dhe retoromanishten (gjysmë për qind). Për Zvicrën, shumëllojshmëria e gjuhëve do të thotë që të gjitha shërbimet e pushtetit qendror ofrohen në të tri gjuhët kryesore (retoromanishtja ka status të veçantë). Kjo do të thotë se kusht për punësim në administratën e pushtetit qendror është njohja e rrjedhshme e së paku dy gjuhëve kombëtare dhe njohje pasive e së tretës. Me fjalë të tjera, shumica gjuhësore po ashtu duhet të ketë sadopak njohuri të gjuhës së pakicës, e jo vetëm e kundërta, tha Agerter.

Eran Kurtish, drejtor i Agencisë së Realizimit të të Drejtave të Bashkësive, foli për rolin e kësaj agjencie në mbrojtjen e bashkësive me përfaqësim më të vogël se 20 për qind dhe për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve.

Ismail Demiroviq, këshilltar në Drejtorinë e Zhvillimit dhe të Përparimit të Arsimit në Gjuhët e Bashkësive, midis tjerash tha se qëllimi kryesor i gjuhës është që njerëzit të këmbejnë mendime, dituri dhe ide, përderisa shkenca e cila merret me hulumtimet gjuhësore është linguistika.



Ana Popova Manasievska, kryetare e Shoqatës së Përkthyesve dhe të Interpretëve (MATA) tha se Dita Europiane e Gjuhëve është shkas i mirë të flasim në temën e gjuhëve dhe se ne duhet të vazhdojmë ta përmirësojmë përdorimin që të jetojmë bashkë.

Veton Zekolli, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Dialog Nansen në Shkup, përkujtoi se në botë fliten 6000-7000 gjuhë të ndryshme, me çka diversiteti gjuhësor shihet në çdo cep të tokës, që duhet pranuar si një pasuri e pashtershme.

E drejta e shprehjes në gjuhë amtare dhe e drejta e arsimit në gjuhë amtare, tha ai, janë të drejta universale të cilat nuk duhet të cenohen, ndërkaq mospërfillja sjell deri te konfliktet e padëshiruara të cilat ndikojnë rrënjësisht në një shoqëri shumetnike e shumëgjuhësore.

Fatmir Iseni, drejtor i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve, tha se RMV si një vend me shumëllojshmëri kulturore, fetare dhe gjuhësore, krijon dhe zbaton politika që zhvillojnë vlerat e unitetit dhe të besimit ndëretnik.

29 shtator 2021

Konferencë shkencore ndërkombëtare e AZGJ-së dhe UEJL-së:
"Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale"

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës në bashkëpunim me Universitetin e Evropës Juglindore organizuan konferencën shkencore ndërkombëtare dyditore, "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale".

Konferenca që nisi sot pasdite në hapësirat e UEJL-së në Shkup është në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, me pjesëmarrës nga institucione të ndryshme arsimore e shkencore nga Maqedonia e Veriut, Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria.

Me këtë rast, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së dhe Luan Përzhita, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike, Republika e Shqipërisë, nënshkruan Memorandum bashkëpunimi.

Tubimin shkencor e hapi drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela, i cili mes të tjerash tha se kjo konferencë tregon se jemi të kujdesshëm ndaj gjërave që na përkasin të gjithëve, siç janë gjuha dhe përkthimi. "Tema e konferencës "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale", paraqet strategji të nevojshme për të diskutuar dhe për të ofruar mundësi dhe alternativa se si t'i zgjidhim dhe si t'i tejkalojmë vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohemi gjatë përdorimit praktikë të gjuhës dhe sidomos gjatë përkthimit", tha ai.

Terminologjia është çështje e ndërlikuar, vazhdoi drejtori i AZGJ-së, duke nënvizuar se edhe nevoja për ta zgjidhur këtë është tepër e madhe. "Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi mund të na çojë drejt saj, duke hedhur nga një gurë në murin e gjatë që rritet çdo ditë, varësisht nga arritjet dhe shpikjet e reja teknologjike e informatike, të cilat sjellin edhe terminologji të re", tha në fjalën e rastit drejtori Ylber Sela.

Konferencën e përshëndeti edhe prorektorja e UEJL-së, Besa Arifi, duke përmendur në fillim pikërisht përvojën e këtij universiteti, i cili në vitin 2001 lindi si nevojë për studime në gjuhën shqipe, por që u bë shembull i një universiteti i cili funksion në tri gjuhë, shqip, maqedonisht dhe anglisht dhe se ato në mënyrë fleksibile përdoren njësoj. "Ky është shembull se si gjuha nuk është barrierë edhe pse ajo ndonjë herë di të jetë e tillë", nënvizoi prorektoroja B. Arifi, duke shtuar se në këtë konferencë do të ketë mundësi të flitet për sfidat e përdorimit të gjuhëve, që nga fëmijëria dhe në faza të tjera.

Në vazhdim, foli edhe Luan Përzhita, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike nga Shqipëria. Ai në fillim vuri në dukje aktivitetet dhe rolin që ka luajtur Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, sidomos me marrëveshjet dhe marrëdhëniet vendosura me institucione shkencore, universitare, arsimore etj. brenda e jashtë vendit, sidomos me ato të Shqipërisë dhe Kosovës, që sipas tij "janë tregues domethënës për të identifikuar institucionin për ta bërë sa më

funksionues". "AZGJ-ja është konsoliduar dhe ka fytyrën e vet, duke u bërë dhe pikë referimi për të tjerë, si dhe përmes botimeve të ndryshme shkencore apo me karakter praktik, si doracakë, etj., me informacione a modele pune për fushën e komunikimit administrativ", tha midis tjerash Luan Përzhita, duke përmendur aktivitetet dhe botimet e shumta që i ka bërë AZGJ-ja.





Në fund, konferencën e përshëndeti edhe Skënder Asani, drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve. Ai tha se bën përshtypje tema e konferencës, sepse ajo është temë aktuale që na imponohet dhe na sfidon në RMV. Kontributet që do të vijnë në konferencë, vuri në dukje ai, do të jenë shtigje orientimi se nga duhet të ecë gjuha shqipe në RMV se si duhet të zbatohet përdorimi zyrtar.

30 shtator 2021

U promovua libri në tri gjuhë "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV"

Në orët e pasdites, në amfiteatrin e UEJL-së në Shkup, në kuadër të Konferencës shkencore "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale"(në organizim të AZGJ-së dhe UEJL-së), u promovua botimi në tri gjuhë (shqip, maqedonisht dhe anglisht), me titull "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV". Për rëndësinë e këtij botimi në fillim foli moderatori, prof. dr. Izer Maksuti nga Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren, Republika e Kosovës, duke njoftuar se paraqet përmbledhje të punimeve të 20 autorëve pjesëmarrës të konferencës shkencore të vitit të kaluar, mbajtur me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, mbajtur më 20-22 shkurt 2020.

Folësi i parë për këtë botim, prof. dr. Mustafa Ibrahimi nga Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, tha se ky botim është hap i mirë, sepse shumë probleme kërkojnë zgjidhje. Ai tha se duhet të definohet gjuha zyrtare, cilët janë kufijtë e përdorimit të saj dhe aftësia për të përkthyer. Me këtë rast përkujtoi se BE-ja angazhohet për modelin e mësimit të tri gjuhëve: gjuhës amtare që duhet të mbrohet, mësimin e gjuhës lokale dhe mësimin e gjuhës zyrtare. Po ashtu afirmoi përvojën e dy universiteteve, UEJL edhe "Nënë Tereza", për mësimin mësim bilingual në to. Për sa i përket statusit të gjuhës shqipe, theksoi ai, kemi një problem të vogël, a do të ketë status ekskluziv, apo vetëm sipas nevojës dhe duke përkujtuar përvojën e disa shteteve, ai tha se modeli i Finlandës është modeli më i mirë. Qeveria dhe shteti, sipas tij, duhet të fokusohet në planifikimin e një strategjie për gjuhët, në mikro dhe makroplan.

Profesoresha nga Universiteti i Prishtinës, Remzije Shahini Hoxhaj, tha se gjuha është pjesa më vitale e komunikimit, e shpesh edhe rrënimit të komunikimit. Çështja e aplikimit të gjuhëve është shumë e rëndësishme në shoqëri dhe, duke cituar Niçen, ajo tha se aplikimi i gjuhëve shpesh është shërues, e shpesh vdekjeprurës. Ne jemi pjesë të një regjioni që e kemi përjetuar këtë në mënyra të ndryshme, nënvizoi ajo, duke i dhënë përkrahje diversitetit kulturor, e në këtë kontekst shprehu bindjen e saj se RMV-ja mund të përdoret si model që mund të përdoret gjithandej, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë. Më tutje, ajo foli në veçanti për përmbajtjen e librit.

Liljana Pandeva, linguiste e angazhuar në AZGJ, foli gjerësisht për të gjitha punimet e përmbledhjes. “Në të vërtetë, autorët e punimeve, janë emra të shquar, profesorë e shkencëtarë nga disa universitete të vendit dhe me gjerë, nga Shqipëria, Kosova dhe Austria, pa praninë e të cilëve, konferenca nuk do ta kishte arritur qëllimin e saj – nderimin e gjuhës amtare, me theks të veçantë në zbatimin e gjuhës shqipe në RMV, si gjuhë e dytë zyrtare. Në këtë kontekst, janë shumica e punimeve të cilat trajtojnë përdorimin institucional të gjuhës shqipe si në aspektin diakronik, ashtu edhe në atë sinkronik”, tha L. Pandeva, e cila pastaj foli hollësisht për çdo punim.

Folësi i fundit për botimin në fjalë ishte profesori nga Universiteti i Tetovës, dr. Izmit Durmishi, i cili, përveç të tjerash, vuri në dukje se prej themelimit të vet AZGJ-ja po vazhdon me ngulm të mbrojë statusin e gjuhëve zyrtare, veçanërisht të shqipes në ligjërimin publik në institucionet shtetërore dhe jo vetëm në to. Për këtë qëllim, theksoi ai, AZGJ-ja bashkëpunon me institucione albanologjike nga vendi dhe nga jashtë, duke ndihmuar zbatimin praktik të gjuhës shqipe.





Konferenca ndërkombëtare përfundon të enjten (30 shtator) me katër panele shkencore, ku do të marrin pjesë albanologë dhe hulumtues të fushave të tjera nga institucione shkencore e arsimore nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Italia dhe Bullgaria.

1 tetor 2021

Përfundoi konferenca "Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale"

Dje, më 30.9.2021 përfundoi konferenca shkencore dyditore, "Terminologjia, dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale". Në këtë konferencë që e organizuan Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe Universiteti i Europës Juglindore, me kumtesa u paraqitën pjesëmarrës nga qendra të ndryshme arsimore e shkencore të Maqedonisë së Veriut, Italisë, Shqipërisë e Kosovës.

Dita e dytë e punës filloi me fjalimet përshëndetëse të profesorëve Valter Memisha, zëvendësdrejtor i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, Sabri Laçi, dekan i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, Berton Sulejmani, dekan i Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Tetovës, Demush Bajrami, dekan i Fakultetit të Gjuhëve, të Kulturave dhe të Komunikimit të Universitetit të Europës Juglindore dhe Ismet Osmani, shef i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Universitetit Shën Cirili dhe Metodi.

Me kumtesë të veçantë u prezantua Jeton Shasivari me temën "Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në Maqedoninë e Veriut midis klisheve paragjykuese dhe kohezionit shoqëror".

Konferenca vazhdoi me prezantimin e kumtesave nga pjesëmarrësit:

- Elena Chiochetti me kumtesën "Vështirësitë terminologjike në gjermanisht si gjuhë e pakicave në Tirolin Jugor: shembulli i shëndetit dhe i sigurisë në punë".
- Evalda Paci me kumtesën "Çështje të terminologjisë shkencore në disa disiplina themelore të albanologjisë (vështrim diakronik dhe analitik)".
- Demush Bajrami, me kumtesën "Mediamorfoza në kurthin e keqinformimit gjuhësor".
- Teuta Toska me kumtesën "Fjalorët Terminologjikë: Pasuri për t'u vlerësuar apo traditë për t'u mënjanuar?".
- Ajten Hajdari – Qamili me kumtesën "Strategjia e harmonizimit të terminologjisë administrative".
- Zeqirja Ibrahimi me kumtesën "Terminologjia profesionale ndërmjet njësimit dhe përkthimit".
- Isa Mulaj, Ruzhdi Matoshi, Florin Aliu me kumtesën e përbashkët

"Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet, detyrat".

- Xhafer Beqiraj me kumtesën "Disa probleme terminologjike në gramatikën e shqipes".
- Izer Maksuti me kumtesën "Roli i terminologjisë profesionale në përkthimin e teksteve të specializuara".

Sipas praktikës që tashmë e ka nisur Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, të gjitha kumtesat e kësaj konference do të përmblidhen në një botim të posaçëm në shqip, maqedonisht dhe anglisht.











2 tetor 2021

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela, në seancën plenare të takimit të XVI të Institutit Alb-Shkenca me temë: "Zbatimi i dygjuhësisë në shoqëritë multietnike: Sfidat dhe përparësitë"

I nderuar moderator i panelit!

Të nderuar panelistë, anëtarë të bashkësisë akademike!

Të dashur miq!

Më lejoni që, në fillim të paraqitjes sime, të falënderoj organizatorin e kësaj ngjarjeje, për ftesën e pjesëmarrjes sime në panelin e sotëm dhe t'ju dëshiroj sukses në organizimin e kësaj ngjarje dhe të ngjarjeve të tjera në të ardhmen.

Në të vërtetë, tema, që është zgjedhur si lëndë e paraqitjes së këtij paneli tematik, është e lidhur ngushtë edhe me funksionin që unë e kryej si i pari i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së.

Nuk ka dyshim se me miratimi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve u bë hap përpara në raport të zbatimit të konceptit të dygjuhësisë në nivel institucional, nëpërmjet përparimit të përdorimit të gjuhës shqipe dhe të përcjelljes së frymës së Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe të amendamentit V të Kushtetutës, që e rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve në një aktvendim ligjor.

Me këtë hap, dygjuhësia është model që tashmë zbatohet në punën e pushtetit qendror dhe lokal; në emrat e institucioneve; në vulat; mbishkrimet dhe udhëtreguesit në pikat kufitare dhe aeroportet; në procedurat para organeve gjyqësore; në procedurat për mbajtjen e evidencës së amzës, lëshimin e dokumenteve personale dhe të pasaportave; në procesin zgjedhor dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore.

Sigurisht që ka disa përjashtime dhe ekzistojnë sfida në lidhje me zbatimin e barabartë të detyrimeve ligjore të subjekteve të qeverisjes publike dhe vendore. Megjithatë, në lidhje me këtë çështje, ekziston institucion tjetër, përkatësisht Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve, si organ kompetent në lidhje me përjashtimet e tilla me qëllim që të njëjtat t'i monitorojë, t'i përcaktojë dhe t'i ndërmarrë veprimet e duhura siç përcaktohet me ligj. Roli i institucionit që unë përfaqësoj është të ndihmojë, të lehtësojë dhe të mbështesë procesin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe besoj se me punën e deritanishme kemi treguar se ligji mund të zbatohet me sukses.

Është e rëndësishme të theksohet se procesi politik që solli në miratimin e ligjit u shoqërua me rezistencë në rrethe të caktuara, por vullneti i aktorëve politikë për miratimin e të njëjtit dhe përjetësimin e tij në praktikë ishte vendimtar si hap drejt arritjes së përpjekjeve për përforcimin e proceseve demokratike, garantimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve dhe përparimin e karakterit shumëgjuhësor të shoqërisë.

Kuptimi im personal është se shkalla e respektimit dhe e ruajtjes së diversitetit gjuhësor është reflektim edhe i shkallës së zhvillimit demokratik të një shteti që përgatitet të jetë pjesë e familjes europiane të shteteve me traditë të pasur demokratike. Në një shoqëri multietnike, multikonfesionale dhe multikulturore siç është Republika e Maqedonisë së Veriut, vlerat e pluralizmit gjuhësor dhe roli i tij koheziv i lidhjes së diversiteteve duhet të riafirmohen dhe ruhen vazhdimisht. Gjuha, në vend që të na ndajë, duhet të na lidhë. Në këtë pjesë, rol të rëndësishëm kanë edhe krijuesit e politikave arsimore, sepse përderisa duam bashkëjetesë dhe ndërveprim më të mirë ndëretnik, është e nevojshme të zbatohet koncepti i arsimit të integruar, që do të lejojë mësimin e gjuhës së shokut, të shokut të klasës të etnitetit tjetër që nga mosha e hershme, me qëllim që të lehtësohet procesi i komunikimit dhe i afrimit ndërkulturor nëpërmjet mësimit të gjuhëve.

Para nesh mbetet shumë punë për t'u bërë për të funksionuar si model i suksesshëm i një shoqërie shumëgjuhëshe. Republika e Maqedonisë së Veriut është shtëpia e të gjithë qytetarëve, e të gjitha etnive. Në vend të rezistencës dhe të ndarjeve, ne duhet të shohim realitetin shoqëror dhe të bashkohemi me prirjet moderne europiane. Në vend të ngecjes, duhet të vazhdojmë të ecim përpara në të ardhmen, duke mësuar nga vendet më të zhvilluara europiane si Zvicra, Belgjika, Finlanda, Luksemburgu, të cilat janë shembuj të funksionimit të suksesshëm të modelit shumëgjuhësor. Për të arritur këtë synim është e nevojshme kohë, por më shumë ndryshim i ndërgjegjes dhe mënyra e shikimit të gjërave.

Më lejoni që, në fund të fjalimit tim, edhe një herë të falënderoj organizatorin për ftesën dhe mundësinë e pjesëmarrjes në panelin e sotëm.



13 tetor 2021

Një ish-prokuror amerikan Xhim Lofton vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së

Sot në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës (AZGJ) qëndroi Xhim Lofton, ish-prokuror amerikan, i cili në Republikën e Maqedonisë së Veriut vjen në kuadër të programit të shkëmbimit të stafit akademik, të njohur si Fulbright.

I shoqëruar nga Ali Musliu dhe Jusuf Zejneli, ligjërues në Universitetin e Tetovës, Lofton u prit nga drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela.

Me këtë rast, ai u informua për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve dhe për themelimin e kësaj Agjencie, përfshi veprimtarinë e saj të deritanishme.

Në Universitetin e Tetovës Xhim Lofton do të ligjërojë lëndën e hyrjes në sundimin e ligjit.





Sela dhe Lofton biseduan edhe për mundësitë e bashkëpunimit dhe të mbështetjes nëpërmjet vendosjes së lidhjeve me ndonjë organizatë që merret me planifikimin gjuhësor.

18 tetor 2021

AZGJ-ja - në hapjen solemne të Ditëve të Hapura të IGJM "Kërste Misirkov"

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i shoqëruar nga Liljana Pandeva, e punësuar në AZGJ, ishte i ftuar dhe mori pjesë në hapjen solemne të Ditëve të Hapura të Institutit të Gjuhës Maqedonase "Kërste Misirkov", gjatë së cilës realizoi takim të shkurtër me drejtoreshën e IGJM-së, Elena Jovanova-Grujovska, të cilës ju dorëzuan përmbledhje të punimeve shkencore nga Konferenca Ndërkombëtare e vitit të kaluar për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, të botuara nga AZGJ-ja.





25 tetor 2021

Drejtori i Agjencisë Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela e vizitoi Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, si dhe drejtori i ITSHKSH-së në Shkup, Skender Asani, me bashkëpunëtorët e tij, vizituan Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, ku u pritën nga rektori prof. dr. Samedin Krrabaj. Gjatë këtij takimi u fol për mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve, veçanërisht duke theksuar disa pika të përbashkëta të cilat mund të jenë në interes të dyanshëm.

Po ashtu, delegacionin në fjalë e priti edhe dekani i Fakultetit të Filologjisë në suaza të këtij universiteti, prof. dr. Flamur Shala i cili shprehu gatishmëri të plotë për bashkëpunim e shkëmbim përvojash për sa i përket kontributit në fushën e gjuhësisë.





26 tetor 2021

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela, në konferencën "Drejt një strategjie të albanologjisë"

Më lejoni që në suaza të kësaj konsulte albanologjike të them disa fjalë për Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së për të cilën më ra barra mua për ta ngritur më këmbë që nga fillimi dhe për ta udhëhequr me përgjegjësinë më të madhe, duke hapur shtigje e rrugë bashkëpunimi e bashkëveprimi me shumë institucione të tjera gjithandej hapësirës shqiptare dhe më gjerë. Në fakt, duke e pasur gjuhën shqipe si detyrë ligjore për ta zbatuar në nivelet zyrtare në RMV, pra duke i ndihmuar institucionet në përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve, të akteve, të vendimeve, të formularëve dhe të gjitha shkresave të nevojshme zyrtare, agjencia jonë po bën një punë të madhe në këtë aspekt, me çka gjithnjë e më tepër po e dëshmon veten se është një institucion i përgjegjshëm dhe dalzotës i gjuhës shqipe.

Por krahas kësaj pune të përditshme që po bën me shërbimet dhe ekipet e saj, po ashtu AZGJ-ja e ka zgjeruar aktivitetin e vet edhe në aspekte të tjera për sa i përket sensibilizimit, kujdesit, trajtimit, promovimit, afirmimit të gjuhës shqipe. Ajo ka organizuar edhe konferenca shkencore që kanë të bëjnë me shumëgjuhësinë dhe sfidat e zbatimit të saj në praktikë, me çështjen e përkthimit, me atë të terminologjisë dhe rolit të saj për njohjen e gjuhës profesionale etj. Kështu, mund të thuhet se është bërë një institucion që i ka hapur dyert për studiuesit dhe gjuhëtarët për të debatuar dhe për të ndërtuar strategji rreth problemeve të gjuhës shqipe.

Në të vërtetë, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, kurrë nuk është mjaftuar vetëm me rolin e saj parësor, thjesht duke mos lejuar të mbetet vetëm si një institucion teknik e administrativ, por ka treguar edhe ambicie shkencore me interes për gjuhën shqipe; me hartim fjalorësh terminologjikë, me debate të ndryshme shkencore, me shënime datash që kanë të bëjnë me gjuhën dhe përkthimin, me hartim doracakësh të ndryshëm, me trajnime për përkthyes dhe për lektorë etj. Në këtë mënyrë ajo është kujdesur vazhdimisht për gjuhën shqipe jo vetëm si një detyrë ligjore, por aq më tepër edhe si një detyrim kulturor, shkencor e kombëtar.

Prandaj, ndihem krenar që në këtë konsultë po marrim pjesë edhe ne si përfaqësues të AZGJ-së, me çka nënkuptohet se jemi një institucion ndoshta i vogël për nga përmasat, por që mund të bëjmë punë të mëdha së bashku duke vepruar sipas një strategjie të nevojshme.
Ju faleminderit!


AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
drejt NJË STRATEGJIE
TË ALBANOLOGJISË
Konsultë
Datë 25, 26 tetor – Universiteti i Shkodrës
Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 3, Tiranë
Tel: +355 42 240 713
Email: info@asa.edu.al





26 tetor 2021

AZGJ-ja – pjesë e strategjisë së albanologjisë

Në një konsultë që u mbajt në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, me temë "Drejt një strategjie të albanologjisë", të cilën e organizoi Akademia e Studimeve Albanologjike, mori pjesë edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij, i cili i përshëndeti të pranishmit duke theksuar se AZGJ-ja tashmë është bërë pjesë aktive e këtyre takimeve, duke dhënë kontributin e vet dhe duke bashkëpunuar në aspektin e trajtimit shkencor të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë ai vuri në dukje se ne së bashku mund të bëjmë shumë punë të rëndësishme të cilat janë në interes të gjuhës shqipe në përgjithësi, si një strategji e albanologjisë.
Drejtori Sela pati takim dhe me rektoren e Universitetit të Shkodrës, zonjën Suzana Golemi, si dhe me përfaqësues të Katedrës së Gjuhësisë.



Po ashtu, drejtori Ylber Sela zhvilloi edhe shumë takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme që merrnin pjesë në këtë konsultë, të cilët shprehën interesim të veçantë për AZGJ-në dhe punën e saj. Me këtë rast, ai u ofroi atyre bashkëpunim për çdo gjë që është në interes të ndërsjellë.

28 tetor 2021

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së, Ylber Sela, me rastin e pjesëmarrjes në Konferencë shkencore ndërkombëtare: "Ballkani midis integrimit europian dhe bashkëpunimit rajonal" të organizuar nga Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup

Ballkani ndërmjet integrimit europian dhe bashkëpunimit rajonal

Integrimi i Rajonit ballkanik dhe vendet e rajonit të tij në familjen e madhe të Bashkimit Europian, është ende përrallë e papërfunduar. Përrallë që ngjan si rrugë e gjatë e paqartë, e mbushur me pengesa të shumta para arritjes te fundi i kësaj rruge. Rrugën, të cilën e ndërtoi babai i BE-së moderne, Robert Shuman, ende po pret të kalohet nga vendet e Ballkanit.

Sot, Bashkimi Europian është forma më e fuqishme e bashkimit dhe e integrimit me tregun nga përafërsisht 500 milionë qytetarë me fuqi të madhe absorbuese, që është rezultat i numrit të popullsisë dhe të të ardhurave të larta për kokë qytetarësh. Përballë kësaj, vendet e Ballkanit të lëna vetëm, janë të vogla, jokonkurruese, me të ardhurat dhe standard jetese mesatar, që kryesisht mbetet pas mesataren europiane dhe me nivel të zhvillimit teknologjik, që nuk mund të jetë konkurrent me nivelin e vendeve-anëtarë të BE-së.

Të udhëhequr nga logjika e fakteve ekonomike, duhet marrë parasysh edhe faktin se, përveç përfitimeve ekonomike, integrimi në Bashkimin Europian siguron paqe, siguri, siguri më të madhe për qytetarët e vet, nivel më të lartë të respektimit të të drejtave njerëzore, sundim të së drejtës, njëkohësisht duke i respektuar dallimet shoqërore.

Jetojmë në kohë kur bota ndryshohet shumë shpejtë, BE-ja ndryshohet, Ballkani ndryshohet, Republika e Maqedonisë së Veriut ndryshohet.
Situata është komplekse, krizat globale dhe krizat me të cilat përballet BE-ja, tani më janë konstantë, vepruesit politikë të udhëhequr nga interesat e qytetarëve dhe vizionit të tyre afatgjatë, duhet t'i drejtojnë vendimet politike kah ana e vërtetë e historisë. Pas vendimeve të tilla, gjeneratat e ardhshme do t'i vlerësojnë – a kanë sjellë vendime të vërteta në momentin e duhur.

Në momentin e sotëm historik dhe rrethanat gjeopolitike, për Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk ka alternativë tjetër përveç integrimit të tërë euroatlantik. Për orientimin e tillë pro-europian ekziston mbështetje e rëndësishme nga qytetarët tanë nga të gjitha bashkësitë etnike dhe fetare, e cila na kushtëzon të kemi durim gjatë rrugës euroatlantike.





Të gjitha vendet ballkanike me përpjekje dhe forca të përbashkëta, të udhëhequra nga qëllimi i fundit të integrimit europian, kanë mundësi nëpërmjet formave dhe nismave të ndryshme për bashkëpunim të përforcuar rajonal, ta përforcojnë procesin e përmirësimit të jetës së qytetarëve të tyre dhe arritjen e standardeve europiane, por bashkëpunimi rajonal nuk mund të paraqesë zëvendësim i integrimit të tërë europian. Politika e zgjerimit është mënyra më e mirë për arritjen e përparimit dhe bashkimit të kontinentit europian. Unë besoj fort në të dhe jam i bindur se procesi i zgjerimit nuk do të jetë përfunduar pa integrimin e tërësishëm të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian.

4 nëntor 2021

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela, në Konferencën shkencore "Kontributi i prof. dr. Qemal Muratit për gjuhësinë shqiptare", të organizuar nga ITSHKSH në Shkup

Të nderuar miq!

Konferenca e sotme shkencore "Kontributi i prof. dr. Qemal Muratit për gjuhësinë shqiptare" në radhë të parë është një konferencë e mirënjohjes për punën e palodhur shkencore të tij, i cili tanimë disa dekada me radhë ka qëndruar përherë në krye të aktiviteteve dhe të debateve që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe kudo në hapësirën tonë. Prandaj, edhe fjala ime në këtë rast është thellësisht një fjalë mirënjohëse dhe konsiderate të plotë për gjithçka që ka bërë në këtë fushë e cila na përket të gjithëve. Aq më tepër, unë ndihem i detyruar dhe krenar njëkohësisht, kur këtë e them edhe në cilësinë e drejtorit të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, ndaj së cilës prof. dr. Qemal Murati ka shprehur gjithmonë vullnet e gatishmëri për ta ndihmuar e për të bashkëpunuar në forma të ndryshme që nga themelimi i saj e deri më sot. Pra, marrëdhëniet e tij me AZGJ-në kanë qenë shumë esenciale dhe jo formale, për arsye se ai ka marrë pjesë në aktivitetet tona shkencore duke shtruar probleme të gjuhës shqipe, të përdorimit të saj në praktikë, të terminologjisë në fusha të ndryshme etj. Sidomos, angazhimi i tij ka qenë i frytshëm dhe konstruktiv edhe me ligjëratat e tij në trajnimin për lektorë dhe për përkthyes të organizuar nga AZGJ-ja, trajnim ky që u mbyll me sukses.

Kështu, mund të them me mburrje se roli dhe angazhimi i prof. dr. Qemal Muratit ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm për institucionin tonë.

Duke u nisur nga kjo, mendoj se konferenca e sotme është plotësisht meritore për prof. dr. Qemal Muratin. Për figurën e tij mund të flitet gjerë e gjatë, por kam bindjen e thellë se këtë gjë më së miri do ta bëjnë pjesëmarrësit e saj me kumtesat e tyre shkencore të cilat do t'i lexojnë në këtë konferencë.

Prandaj ju uroj punë të mbarë! Po ashtu, edhe prof. dr. Qemal Muratit i uroj shëndet e mbarësi edhe më tej në punën e tij shkencore në fushën e gjuhësisë shqiptare!





11 nëntor 2021

AZGJ-ja dhe Fondacioni "Fridrih Ebert" u dakorduan për bashkëpunim

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , Ylber Sela, realizoi takim pune me delegacionin e Fondacionit Fridrih Ebert (Friedrich Ebert Stiftung) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të udhëhequr nga z. Rene Shlee, drejtor për Maqedoninë e Veriut dhe z. Valon Sadiki, koordinator i programit.

Duke e falënderuar për takimin, drejtori Sela e afirmoi rolin e rëndësishëm të fondacionit, si fondacion më i vjetër politik në Gjermani, në mbështetjen e nismave dhe projekteve për bashkëpunimin paqedashës, avancimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa njëkohësisht e njoftoi bashkëbiseduesin e tij me punën e deritanishme të AZGJ-së. Në këtë kontekst, të dy bashkëbiseduesit patën mundësinë të këmbejnë mendime në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm mes të dyja institucioneve.



Të dyja palët e vlerësuan takimin si mjaftë të dobishëm dhe theksuan se do të jenë të hapura për vazhdimin e komunikimit dhe bashkëpunimit në projekte me interes të ndërsjellë.

14 nëntor 2021

Ditët e Alfabetit

"Ditët e alfabetit" nisën sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup.

Aktivitetet shkencore mbi letërsinë, gjuhën dhe traditën arbëreshe që do zgjasin deri më 22 nëntor. Agjencia e Zbatimit të Gjuhës është pjesë e aktiviteteve për "Ditët e alfabetit" ku sivjet u është përkushtuar Arbëreshëve si vlerë e çmuar e trungut tonë kombëtar.



Drejtori i Azgj-së, Ylber Sela pati fjalë përshëndetëse para të pranishmëve.

16 nëntor 2021

Mirënjohje e AZGJ-së për gazetarin Seladin Xhezairi

Doajeni i gazetarisë shqiptare, Seladin Xhezairi, i cili u pensionua këto ditë, dje e vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, të cilin e priti drejtori Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij.



Me këtë rast ai i shprehu mirënjohje të thellë për punën profesionale në TV KLAN, si dhe për kujdesin që ka treguar ndaj AZGJ-së që nga fillimi i saj, duke i lënë përherë hapësirë për t'i prezantuar sukseset e saj në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore.

Po ashtu, drejtori i Agjencisë ia dhuroi edhe disa nga botimet e AZGJ-së, si dhe një gravurë në shenjë kujtimi.

17 nëntor 2021

Fjalë përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në promovimin e librit "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit" të Fatmir Toçit

Në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, dje u promovua libri me titull "Arbëreshët midis realitetit dhe mitit" të autorit Fatmir Toçi.

Para shumë pjesëmarrësve, përfaqësues të jetës kulturore, shkencore, politike, mediatike, në mesin e të cilëve edhe ish-kryetari Shqipërisë, Alfred Mojsiu, për librin folën Dorian Koçi dhe Rami Memushaj.

Po ashtu, të pranishmit i përshëndeti edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, i cili theksoi se ky libër del në dritë dhe përputhet me aktivitetet që po zhvillohen në RMV, në suaza të Ditëve të Alfabetit, ku si temë janë arbëreshët, gjuha, kultura, letërsia dhe tradita e tyre.



Në këtë mënyrë, vijoi më tej ai, është e nevojshme të theksohet se vëmendja dhe kujdesi ndaj arbëreshëve vazhdon të rritet gjithandej. Prandaj, edhe ky libër i Fatmir Toçit duket se është i tillë dhe shpresoj të hapë horizonte për t'i njohur arbëreshët më mirë, sidomos t'u shërbejë përfaqësuesve të politikës për të ndihmuar më shumë për sa i përket kësaj diaspore të vjetër e cila e ruajti qenien kombëtare deri në ditët e sotme, theksoi drejtori Ylber Sela.

19 nëntor 2021

Fjala përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në konferencën kushtuar studiuesit Anton Nikë Berisha në kuadër të "Ditëve të Alfabetit"

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni ta përshëndes këtë aktivitet i cili zhvillohet në suaza të Ditëve të Alfabetit, ku sivjet si temë qendrore janë arbëreshët, gjuha, kultura, letërsia dhe tradita e tyre.

Duke qenë se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, të cilën e udhëheq unë, po i ndjek rregullisht këto aktivitete, kam bindjen e thellë se edhe ky i sotmi që i kushtohet studiuesit të njohur Anton Nikë Berisha, është një kontribut i rëndësishëm për të hedhur dritë mbi figurën e tij, i cili është marrë në mënyrë të veçantë me letërsinë dhe kulturën arbëreshe.

Në këtë kontekst, vetë fakti se lënda e pare e krijimit të letërsisë është gjuha, aq më tepër na obligon që të jemi pranë saj si një institucion që kujdeset për zbatimin, mbrojtjen dhe afirmimin e saj. Për këtë arsye, dua të theksoj se bota arbëreshe na përket të gjithëve; është ndjenja dhe krenaria jonë, është gjaku i shprishur që rikthehet në qenien tonë. Thjesht, nëpërmjet arbëreshëve ne tregojmë përgjegjësinë tonë kombëtare dhe institucionale. Duke i nderuar personalitetet që flasin për ta, ne i nderojmë edhe arbëreshët.

Pa e zgjatur më tepër, shpresoj dhe uroj që pjesëmarrësit të japin ndihmesën e tyre për figurën e Anton Nikë Berishës, por edhe për arbëreshët e Italisë.

Ju faleminderit!



21 nëntor 2021

Fjala përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në aktivitetin e zhvilluar në Shtëpinë e Alfabetit në Manastir

Të nderuar miq!

Më lejoni të them disa fjalë në kontekstin e aktiviteteve që po zhvillohen në suaza të Ditëve të Alfabetit, ku si temë është kauza arbëreshe për gjuhën shqipe dhe për albanologjinë. Vizita jonë në Manastir nuk është një formalitet, por është një esencë për faktin se ne bartësit e institucioneve kthehemi në kohë për të kujtuar paraardhësit tanë të cilët i vunë themelet e gjuhës shqipe.

Nëse arbëreshët e ngjallën këtë gjuhë nga harresa, pjesëmarrësit e Kongresit të Alfabetit më 1908 e vunë atë në binarët e shkrimit të njësuar, pra duke zgjedhur një alfabet të përbashkët të cilin e kemi sot.

Në këtë kuptim, sot aq më tepër ne detyrohemi që të jemi mirënjohës për këtë vendosmëri e kontribut të tyre, por edhe përgjegjës dhe të vëmendshëm ndaj gjuhës shqipe, duke e ruajtur, kultivuar e afirmuar atë në të gjitha instancat shkencore, kulturore, akademike, arsimore, shoqërore e politike.

Duke qenë në krye të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, mua më bie kjo barrë që të bëj maksimumin për sa i përket zbatimit praktik të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore, jo vetëm si një detyrim ligjor, por aq më tepër edhe si një detyrim kombëtar.

Meqë ndodhemi në këtë tempull të gjuhës shqipe, siç është Shtëpia e Alfabetit, dëshiroj ta shfrytëzoj rastin për të bërë apel që ta mbrojmë dhe kultivojmë gjuhën shqipe, ta flasim me ndjenjë dhe me zemër, ta shkruajmë me shkronjat që dolën nga kjo shtëpi, sepse nuk kemi trashëgimi më të çmuar se kjo.

Uroj që kjo festë të jetë testament dhe reflektim, metafizikë dhe krenari kombëtare!

Ju faleminderit!


IN "MUZEU I ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE"
MANASTIR
113 VJETORI I
"KONGRESIT TË
MANASTIRIT"


MIRËNJOHJE



22 nëntor 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela mori Çmimin "22 Nëntori"

Para shumë pjesëmarrësve, përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, kulturore, shkencore etj., në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u dorëzua solemnisht Çmimi "22 Nëntori". Fitues i sivjemë është prof. dr. Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës.

Ky çmim ndahet si mirënjohje për arritjet në sferën e jetës politike, kulturore dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për kontributin në avancimin e bashkëjetesës ndërnjerëzore dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive, kulturave dhe besimeve të ndryshme. Prof. dr. Ylber Sela për këtë çmim u nominua nga Shoqata për kulturë dhe art "Tradita" nga Tetova, të cilën e udhëheq mr. Selam Sulejmani.

Prof. dr. Ylber Sela u shqua për angazhimin e tij të pakursyer në ngritjen dhe konsolidimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së. Prandaj ky çmim i lartë shtetëror është njëkohësisht edhe mirënjohje për këtë agjenci e cila vazhdon t'i mbështesë dhe t'i ndihmojë institucionet për ta zbatuar gjuhën shqipe.



22 nëntor 2021

AZGJ-ja promovoi librin "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019"

Në praninë e një numri të madh pjesëmarrësish, përfaqësues të jetës politike, arsimore, kulturore e shkencore, në mesin e të cilëve edhe kryetari i Kuvendit të RMV-së, Talat Xhaferi dhe zëvendëskryeministri i parë të Qeverisë së RMV-së, Artan Grubi, në amfiteatrin e UEJL-së në Shkup u promovua libri me titull "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019" të bashkautorëve Ylber Sela, Jusuf Zejneli, Jeton Shasivari, Argëtim Saliu, Llazo Matovski dhe Valbona Hajretini.

Në fillim, të pranishmit i përshëndeti drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela i cili foli për punën e palodhur të autorëve, si dhe për ekipet e AZGJ-së, të cilat punuan rreth përgatitjes dhe botimit të këtij libri.

Një fjalë rasti e mbajti edhe zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së RMV-së, Artan Grubi, i cili theksoi rolin e rëndësishëm të AZGJ-së dhe të Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve, si dy institucione të cilat kujdesen për ta zbatuar gjuhën shqipe në nivelet zyrtare.

Po ashtu, të pranishmit i përshëndeti edhe zëvendësrektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, prof. dr. Valter Memisha.

Ndërkaq, për vlerat e librit në fjalë folën recensentët prof. dr. Adnan Jashari dhe prof. dr. Izer Maksuti, të cilët i vunë në dukje disa nga aspektet e këtij studimi që ka të bëjë me ecurinë dhe avancimin ligjor të gjuhës shqipe në RMV.

Në fund, në emër të autorëve doli prof. dr. Jeton Shasivari.





Ylber Sela
Jeton Shasivari
Argëtim Saliu
Jusuf Zejneli
Valbona Hajretin
Llazo Matovski

GJUHA SHQIPE PARA DHE PAS MIRATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE TË VITIT 2019

Shkup, 2021

Илбер Села
Јетон Шасивари
Аргетим Салиу
Јусуф Зејнели
Ваљбона Хајретин
Лазо Матовски

АЛБАНСКИОТ ЈАЗИК ПРЕД И ПО УСВОЈУВАЊЕТО НА ЗАКОНОТ ЗА УПОТРЕБА НА ЈАЗИЦИТЕ ОД 2019 ГОДИНА

Скопје, 2021

Ylber Sela
Jeton Shasivari
Argëtim Saliu
Jusuf Zejneli
Valbona Hajretin
Llazo Matovski

ALBANIAN LANGUAGE BEFORE AND AFTER THE APPROBATION OF THE LAW ON THE USE OF LANGUAGES OF THE YEAR 2019

Skopje, 2021

24 nëntor 2021

Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar të Shqipërisë, Dorian Koçi e vizitoi AZGJ-në

Gjatë ditës së djeshme, Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së e vizitoi drejtori i Muzeut Historik Kombëtar të Shqipërisë, Dorian Koçi, të cilin e priti homologu i tij Ylber Sela.



Me këtë rast drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela e njoftoi atë lidhur me punën që po bën ky institucion në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në nivelet zyrtare.

Po ashtu, të dy homologët shkëmbyen shumë ide duke biseduar edhe mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve.

24 nëntor 2021

Biblioteka e AZGJ-së u pasurua edhe me disa fjalorë

Gjatë vizitës në Tiranë, një delegacion i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, të kryesuar nga drejtori Ylber Sela, u takua edhe me zëvendësrektorin e Akademisë së Studimeve Albanologjike, Valter Memisha. Me këtë rast, me ndihmën e tij arriti të sigurojë një numër të konsiderueshëm fjalorësh të ndryshëm, sidomos fjalorët terminologjikë nga fusha të ndryshme.

Tanimë këta fjalorë do ta pasurojnë bibliotekën e AZGJ-së, për nevojat e përkthyesve dhe të lektorëve.



24 nëntor 2021

AZGJ-ja dhe TIKA po intensifikojnë bashkëpunimin

Sot, delegacioni i Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim – TIKA në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e udhëhequr nga z. Halim Omer Sogut, koordinator programi i TIKA-s në Shkup, e vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së , ku u mirëprit nga drejtori Ylber Sela.

Vizita e delegacionit të TIKA-s është vizitë kthyese në agjenci pas takimit të punës së drejtorit Sela me ekipin e tij në selinë e TIKA-s në Shkup, në shtator të këtij viti.



Drejtori Sela e shprehu kënaqësinë e tij ndaj bashkëbiseduesit për zhvillimin pozitiv të deritanishëm të marrëdhënieve me TIKA-n, ku u diskutua për mbështetjen e mundshme nga TIKA për furnizimin e pajisjeve teknike për nevojat e AZGJ-së në kryerjen e trajnimeve dhe trajnime të specializuara për përkthim simultan, si dhe organizimin e manifestimeve dhe promovimeve në shqip, në turqisht, në maqedonisht dhe në gjuhë të tjera të pjesëtarëve të komuniteteve, si dhe realizimin e një vizite studimore të ekipit të Agjencisë të institucioneve simotra, si dhe atyre shkencore-arsimore në Republikën e Turqisë.

Të dyja palët ranë dakord që AZGJ-ja dhe TIKA hodhën themelet për miqësi të fortë dhe bashkëpunim të ndërsjellë, që do të vazhdojë të zhvillohet në të ardhmen.

26 nëntor 2021

AZGJ-ja dhe Qendra e Arsimit Profesional dhe e Trajnimeve nisin bashkëpunimin

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela, sot ka realizuar takim pune me drejtorin e Qendrës së Arsimit Profesional dhe të Trajnimeve, z. Sherif Miftari dhe Ali Shahini përkthyes profesional në këtë institucion, i cili siguron përkrahje dhe zhvillim të arsimit profesional në të gjitha subjektet e interesuara për arsim profesional në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë këtij takimi drejtori Sela dhe drejtori i Qendrës së Arsimit Profesional dhe të Trajnimeve biseduan lidhur me Zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në institucionet shtetërore, ndërkaq drejtori Sela ofroi mbështetje për lekturë të të gjitha materialeve nga drejtimet dhe programet mësimore që ata i përgatisin.



Bashkëbiseduesit u dakorduan për bashkëpunime të mëtejshme në të ardhmen mes dy institucioneve, në mënyrë që nxënësve t'u sigurohet mësim programor sa më cilësor.

Drejtori Sela edhe njëherë apelon te të gjitha institucionet që kanë nevojë për lekturë profesionale, të materialeve që kanë rëndësi të veçantë për gjuhën, të dërgohen te ne në agjenci, në mënyrë që të kemi përkthime sa më cilësore dhe më pak gabime gjuhësore.

29 nëntor 2021

Zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve – tema e takimit me Inspektoratin e Përdorimit të Gjuhëve

Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës të RMV-së sot e vizitoi drejtori i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve, z. Fatmir Iseni, i cili u mirëprit nga kolegu i tij, drejtori Ylber Sela.

Tema e bisedës së takimit të punës ishte zbatimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve dhe vështrimi i gjendjes në raport me zbatimin e deritanishëm të saj. Drejtori Sela u njoh me vijimin e përgatitjeve të Inspektoratit në pjesën e licencimit të inspektorëve, të cilët do të kryejnë mbikëqyrje dhe monitorim inspektues lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në nivel institucional, njëkohësisht i ofroi edhe mbështetje drejtorit Iseni në pjesën e fillimit të aktiviteteve në terren për përcaktimin e gjendjes faktike lidhur me zbatimin e tërësishëm dhe konsekuent të aktvendimit ligjor, nëpërmjet zbatimit joselektiv të instrumenteve të mbikëqyrjes inspektuese.



Të dy bashkëbiseduesit u dakorduan se bashkëpunimi mes AZGJ-së dhe Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve është në një nivel të lartë dhe se interesi i përbashkët është sigurimi i mundësive të njëjta të qytetarëve gjatë realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, me respektimin e ligjit në aspektin e realizimit të përpjekjeve qeveritare për krijimin e një shoqërie për të gjithë qytetarët.

1 dhjetor 2021

Vizitë pune në SHA "MEPSO"

Drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës (AZGJ), Ylber Sela, i shoqëruar nga ekipi i tij, sot ka vizituar SHA "MEPSO"-n, ku ka pasur takim pune me drejtorin e përgjithshëm, kryetarin e Bordit Drejtues, Kushtrim Ramadani, ku morën pjesë edhe anëtarë të Bordit Drejtues të SHA "MEPSO".

Vizita u realizua me nismë të drejtorit Sela, për ta parë situatën rreth zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në SHA "MEPSO", u diskutua për disa dilema dhe vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve për çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare.



Për shkak të zhvillimit të pandërprerë të proceseve të punës, drejtori Sela ofroi mbështetje në pjesën e ndihmës profesionale për lekturimin e formularëve dhe dokumenteve zyrtare. Nga ana tjetër, z. Ramadani e njoftoi bashkëbiseduesin për hapat e deritanishëm në zbatimin e ligjit dhe shprehu gatishmërinë dhe vullnetin për përmirësimin dhe avancimin e situatës sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe, përmes procesit të bashkëpunimit dhe me mbështetjen e AZGJ-së.

Në fund të takimit, drejtori Sela i dorëzoi bashkëbiseduesit një komplet botimesh të botuara nga AZGJ-ja, lidhur me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

6 dhjetor 2021

Bashkëpunim i dakorduar mes AZGJ-së dhe Klinikës Universitare të Neurologjisë

Ushtruesi i detyrës, drejtor organizativ i ISHP Klinikës Universitare të Neurologjisë, Alajdin Havziu, sot vizitoi AZGj-në, ku u prit nga drejtori i saj, Ylber Sela.

Në këtë takim, të dy bashkëbiseduesit diskutuan në lidhje me zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në punën e këtij institucioni shëndetësor. Drejtori Sela, pas shqyrtimit të gjendjes në klinikë, i ofroi mbështetje të plotë në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore, me ndihmë profesionale nga AZGJ-ja në lidhje me përkthimin dhe lekturimin e formularëve dhe akteve të ndryshme në përdorim zyrtar.




Drejtori Havziu e falënderoi për mbështetjen dhe ndihmën e ofruar, duke premtuar se do të përpiqet për zbatimin e gjuhës shqipe në klinikë sipas detyrimeve ligjore.

6 dhjetor 2021

U hap ekspozita “Hasan Prishtina në dokumentet arkivore”

Me rastin e shënimit të 100 vjetorit të emërimit të Hasan Prishtinës si kryeministër i Shqipërisë, në sallën e Ministrisë së Sistemit Politik në Shkup u hap ekspozita me titull “Hasan Prishtina në dokumentet arkivore”, të cilën e organizuan Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë. Para pjesëmarrësve folën zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së RMV-së, Artan Grubi, drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, drejtori i përgjithshëm i APSH-së, Ardit Bido dhe pasardhësi i familjes së Hasan Prishtinës, Mehmet Prishtina.

Krahas kësaj, po ashtu, drejtori i përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, Artan Bido e vizitoi edhe Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, të cilin e priti drejtori i saj Ylber Sela. Me këtë rast ai u njoftua lidhur me punën e vazhdueshme që po bën ky institucion lidhur me zbatimin e gjuhës shqipe në nivele zyrtare, duke i mbështetur dhe ndihmuar institucionet shtetërore në aspektin e përkthimit dhe të lekturimit të dokumenteve dhe të shkresave të tjera zyrtare.





9 dhjetor 2021

Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës në RMV e vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup

Konsulli i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës në RMV, z. Agim Krasniqi, u prit në një takim nga z. Ylber Sela, drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës. Gjatë takimit, drejtori Sela foli për funksionimin dhe punën e gjithanshme të këtij institucioni të rëndësishëm dhe sukseset e arritura në zbatimin e gjuhës shqipe në nivel zyrtarë, duke filluar nga themelimi e deri me sot.



Ai potencoi edhe ndihmën dhe mbështetjen e institucioneve shtetërore në aspektin e përkthimit dhe lekturimit të dokumenteve dhe shkresave të ndryshme zyrtare.

Z. Krasniqi e falënderoi për pritjen dhe e çmoi lart angazhimin dhe punën që bën Agjencia dhe drejtori Sela në zbatimin e Ligjit të Zbatimit të Gjuhëve, gjithnjë në interes të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

10 dhjetor 2021

Drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela mori Çmimin "Ambasador për imazhin shqiptar në botë"

Në praninë e shumë personaliteteve të shquara shqiptare të shkencës, artit, kulturës etj., në mjedisin pitoresk të Vila Parkut në Prizren, Forumi Imazh – Media organizoi një solemnitet madhështor, në të cilin i dorëzoi çmimet "Ambasador për imazhin shqiptar në botë". Këtë çmim të rëndësishëm e mori edhe drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela me motivacionin për kontributin e dhënë në zbatimin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, si dhe për kontributin e dhënë në forcimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.



Me këtë rast, z. Sela i falënderoi përfaqësuesit e forumit në krye me drejtuesin e saj, Astrit Memia, duke theksuar se ky çmim është i dyti me radhë që më jepet sivjet, pas atij të 22 Nëntorit. Pa dyshim, shtoi më tej ai, çmimi është mirënjohje për punën që po bëjmë me ekipin tim në institucionin të cilin e udhëheq në lidhje me zbatimin e gjuhës shqipe.

10 dhjetor 2021

Fjala përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në promovimin e veprimtarisë shkencore të Begzat Baliut

Të nderuar të pranishëm!

Më lejoni të shpreh kënaqësinë time për këtë aktivitet që ka të bëjë me promovimin e veprimtarisë së studiuesit Begzat Baliu, veçmas të fjalorit në veprën e Ymer Elshanit, aktivitet ky që po zhvillohet në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet institucion i pranueshëm nga të gjitha qarqet shkencore e kulturore anekënd hapësirës shqiptare.

Pa dyshim, AZGJ-ja gjithmonë i ka hapur dyert për takime e ngjarje të këtilla, të cilat e promovojnë shkencën dhe kulturën shqiptare, sidomos studimet që paraqesin kontribut të rëndësishëm për gjuhësinë tonë. Neve na lidh gjuha shqipe si detyrim kombëtar, prandaj ndjejmë kënaqësi kur gjithsecili prej nesh jep kontribut në këtë fushë.

Detyra e AZGJ-së është të ndihmojë çdo aktivitet që ka të bëjë me gjuhën shqipe, prandaj edhe për sa u përket veprave të mikut tonë, Begazat Baliu, ne jemi të gatshëm të jemi bartës të promovimit dhe afirmimit të tyre.

Pa dashur që ta zgjas më tepër, uroj që ky aktivitet të shërbejë si një ndërgjegjësim dhe sugjerim për të gjithë ata që merren me problemet e gjuhës shqipe, që ta kthejmë vëmendjen nga këto vepra të cilat janë pjesë e shkencës dhe e kulturës sonë, për ta ndërtuar dhe plotësuar vizionin ndaj gjuhës shqipe.



10 dhjetor 2021

Fjala përshëndetëse e drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në promovimin e librave të Shaban Muratit

Të nderuar miq!

Jam shumë i nderuar t'ju përshëndes të gjithë juve, miq të ambasadorit Shaban Murati, dashamirësve të librit e të kulturës. Fillimisht dëshiroj të theksoj faktin se kënaqësia është e dyfishtë kur si shkas për këtë po bëhet pikërisht diplomati i karrierës dhe ambasadori Shaban Murati, me dy librat e tij "Vetëvrasja diplomatike e Kosovës dhe e Shqipërisë" dhe "Deti midis Shqipërisë dhe Greqisë", dy libra të cilat trajtojnë pikat më nevralgjike të shqiptarëve në raportet ndërkombëtare.

Duke qenë se ambasadori Shaban Murati ka një përvojë të gjatë diplomatike, si një njohës i thellë i këtyre problemeve, në dy librat e tij ai shkruan në mënyrë shumë empirike, duke e mbështetur çdo gjë në fakte, situata konkrete, në kontekste e raporte të cilat ende janë të freskëta dhe ende vazhdojnë të trazojnë marrëdhëniet tona me fqinjët. Nga kjo pikëpamje librat e ambasadorit Shaban Murati lëshojnë një alarm të fuqishëm për shtetet shqiptare, për elitat politike të cilat i udhëheqin shtetet tona, që të ndërgjegjësohen dhe të aktivizohen me gjithë potencialin dhe kapacitetin e tyre institucional, intelelektual dhe diplomatik, në mënyrë që ta mbrojnë qenien kombëtare, përkatësisht territorin tonë ndaj të cilit pretendojnë fqinjët.

Detyrimisht kjo është një çështje shumë e ndijshme dhe e brishtë, prandaj duhet angazhim serioz, guxim dhe vizion i plotë. Mendoj se të gjitha këto na i ofrojnë librat e ambasadorit Sh. Murati, bëhen udhëzues konstruktiv dhe real për t'i kapërcyer me dinjitet e maturi. Në të vërtetë, leximi i këtyre librave na kthen në qenien tonë për t'u ndjerë shqiptarë dhe për ta mbrojtur veten nga çdo pretendim agresiv ose keqpërdorim i mundshëm.

Pa dashur që ta zgjas më tepër, uroj që librat e mikut tonë ta gjejnë udhën e tyre te lexuesit, sidomos tek elitat shtetërore të cilat duhet t'i mbajnë si doracak të domosdoshëm nëpër zyrat e tyre për të kuptuar gjendjen dhe mundësinë tonë në fushën e diplomacisë.




Shaban Murati
VËTËVRASJA DIPLOMATIKE
E KOSOVËS DHE
E SHQIPËRISË
DETI
MIDIS
SHQIPËRISË
DHE
GREQISË
albas

11 dhjetor 2021

Studiuesja Elona Gjata e vizitoi AZGJ-në

Studiuesja shqiptare nga Tirana, Elona Gjata e vizitoi Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup, të cilën e priti drejtori Ylber Sela.

Gjatë këtij takimi, ai e njoftoi në lidhje me punën e përditshme që po bën AZGJ-ja për zbatimin e gjuhës shqipe në institucionet shtetërore të RMV-së. Krahas kësaj, ai e njoftoi edhe me aktivitetet e tjera që po zhvillon ky institucion në interes të ruajtjes dhe afirmimit të gjuhës shqipe.



Në kontekst të kësaj ata biseduan edhe për mundësinë e bashkëpunimit në të ardhmen për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe.

14 dhjetor 2021

Një grup studentësh të UEJL-së e vizituan AZGJ-në

Gjatë ditës së sotme, një grup studentësh të Universitetit të Europës Juglindore, përkatësisht të Fakultetit të Shkencave Shoqërore Bashkëkohore dhe Fakultetit të Gjuhëve, të Kulturave dhe të Komunikimit, të shoqëruar nga prof. dr. Liljana Siljanovska, e vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup.



Studentët i priti drejtori Ylber Sela, i cili i njoftoi ata lidhur me procesin e punës së përditshme që po bën ky institucion në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe në nivele zyrtare.

Ndërkaq, në lidhje me strukturën dhe organizimin e AZGJ-së, studentëve u foli përgjegjësja e Njësisë së burimeve njerëzore, Valmira Axhirexha.

15 dhjetor 2021

Fjalimi i drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela në edicionin XII të ditëve të albanologjisë

Të nderuar miq!


Në fillim, më lejoni t'i them disa fjalë në suaza të këtij aktiviteti që ka të bëjë me albanologjinë. Është e kuptueshme se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe në RMV, preokupim kryesor e ka gjuhën shqipe dhe zbatimin e saj praktik në institucionet shtetërore të këtij vendi.

Megjithatë, krahas kësaj, ne gjithnjë e më tepër po e zgjerojmë aktivitetin tonë edhe në aspektin shkencor, duke e trajtuar atë nëpërmjet takimeve e tubimeve shkencore që i kemi organizuar deri tani, me botimet e ndryshme shkencore që kemi bërë etj. Prandaj, edhe prania jonë në këtë rast, është vetëm një vazhdimësi për të dhënë kontributin tonë modest në trajtimin e gjuhës shqipe si çështje kryesore e shkencës së albanologjisë.

Nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet anekend hapësirës shqiptare dhe më gjerë, ne kemi arritur që ta afirmojmë interesimin, rolin dhe angazhimin tonë në interes të gjuhës shqipe. Duke iu përgjigjur edhe Ditëve të Albanologjisë, aq më tepër po dëshmojmë se vendosmëria jonë është e plotë, për t'u bërë zë i përbashkët në të gjitha strategjitë e studimeve albanologjike, veçanërisht e pjesës që ka të bëjë me gjuhën shqipe.

Ne jemi të vetëdijshëm se kjo është një fushë shumë e gjerë, por mjafton që nëpërmjet angazhimit tonë të jemi pjesë e këtij mozaiku që mbështet, bashkëpunon, kontribuon dhe hedh dritë për gjuhën shqipe. Angazhimi i studiuesve dhe gjuhëtarëve më të spikatur shqiptarë në aktivitetet tona, konsultimet për çështje të ndryshme terminologjike, ndërtimi i strategjive për harmonizimin e terminologjisë në mbarë hapësirën shqiptare, përgatitja e doracakëve të ndryshëm gjuhësorë, përpilimi i fjalorëve etj., janë vetëm disa orientime e projekte konkrete të cilat i kemi realizuar deri tani në suaza të institucionit tonë. Por kjo veprimtari do të vazhdojë edhe më tej duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet albanologjike që të jemi në sinkroni të plotë për sa i përket trajtimit dhe studimit të gjuhës shqipe.

Pa dashur që ta zgjas më tepër, në fund dua të theksoj se Agjencia e Zbatimit të Gjuhës Shqipe po ndjek rrugën e një partneriteti strategjik në studimet albanologjike, përkatësisht atyre gjuhësore. Në këtë kuptim ne përpiqemi që me punën dhe angazhdimin tonë ta ngremë atë në nivelin e lakmueshëm, duke hapur rrugë të gjera bashkëpunimi e shkëmbimi shkencor. Këtu duhet theksuar se vëmendja jonë ndaj institucioneve të tjera është e madhe, por është me interes që edhe vëmendja e të tjerëve të jetë e njëjtë ndaj nesh. Duke qenë pranë njëri-tjetrit për interesat e gjuhës shqipe, ne do t'i përmbushim detyrimet tona shkencore, por edhe ato kombëtare.





16 dhjetor 2021

Akademia e Studimeve Albanologjike të Tiranës i dha mirënjohje drejtorit të AZGJ-së, Ylber Sela

Në suaza të Ditëve të Albanologjisë që u mbajtën në Tiranë, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme shkencore, po ashtu mori pjesë edhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, e kryesuar nga drejtori i saj Ylber Sela dhe bashkëpunëtorët e tij. Me këtë rast ai i përshëndeti të pranishmit duke theksuar se nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellë me institucionet anekënd hapësirës shqiptare dhe më gjerë, AZGJ-ja ka arritur ta afirmojë interesimin, rolin dhe angazhimin në interes të gjuhës shqipe. Duke iu përgjigjur edhe Ditëve të Albanologjisë, shtoi më tej ai, aq më tepër kemi dëshmuar se vendosmëria jonë është e plotë për t'u bërë zë i përbashkët në të gjitha strategjitë e studimeve albanologjike, veçanërisht e pjesës që ka të bëjë me gjuhën shqipe.

Në fund, u ndanë edhe mirënjohje për kontributin kërkimor e shkencor të personaliteteve e të institucioneve. Me këtë rast, rektori i Akademisë së Studimeve Albanologjike, prof. dr. Luan Përzhita i dha mirënjohje edhe drejtorit të AZGJ-së, prof. dr. Ylber Selës për kontributin në aspektin e zbatimit, mbrojtjes dhe afirmimit të gjuhës shqipe.



22 dhjetor 2021

Nxënësit e SHFK "Jeronim de Rada" e vizituan AZGJ-në

Një grup nxënësish të talentuar të SHFK "Jeronim de Rada" nga fshati Çerkez i Kumanovës, përkatësisht anëtarë të grupit letrar dhe të grupit të piktorëve në suaza të kësaj shkolle, të udhëhequr nga arsimtari i gjuhës shqipe Emrah Bilali dhe arsimtari i artit, Dali Alili, vizituan Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës në Shkup.



Ata i priti drejtori i AZGJ-së, Ylber Sela me bashkëpunëtorët e tij, i cili i njoftoi ata në lidhje me punën e përditshme që bën ky institucion për zbatimin e gjuhës shqipe në RMV. Gjatë këtij takimi u zhvullua një bashkëbisedim i hapur, ku ata u interesuan për shumë çështje që kanë të bëjnë me gjuhën, me profesionin, me perspektivën shoqërore etj.

Me këtë rast, nxënësit e kësaj shkolle i dhanë një mirënjohje, si dhe një portret drejtorit Ylber Sela për punën që po bën në AZGJ.

22 dhjetor 2021

Takim për aktivitetet e vitit 2022

Në përmbyllje të këtij viti, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, Ylber Sela zhvilloi një takim me dekanët prof. dr. Berton Sulejmani dhe prof. dr. Lulzim Mehmedi nga UT, prof. dr. Ismet Osmani, shef i Katedrës së Albanologjisë, në Universitetin "Shën Cirili e Metodij" në Shkup, prof. dr. Mustafa Ibrahimi nga Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup si dhe prof. dr. Demush Bajrami nga UEJL i lidhur onllajn.



Gjatë kësaj bisede, ai shpalosi planet për aktivitetet e parapara të AZGJ-së të cilat do t'i zhvillojë gjatë vitit 2022. Gjithsesi, pjesë e bisedës ishte edhe bashkëpunimi me fakultetet dhe katedrat të cilat do të jenë pjesë e aktiviteteve të AZGJ-së gjatë vitit të ardhshëm.

31 dhjetor 2021

Viti 2021 – vit shumë i frytshëm për AZGJ-në

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së po e mbyll vitin 2021 me suksese të shumta, duke e përmbushur plotësisht detyrimin dhe misionin e saj. Në radhë të parë, ajo në mënyrë të pakursyer i ka ndihmuar institucionet shtetërore në aspektin e zbatimit të gjuhës shqipe, duke përkthyer e lekturuar dokumentet, formularët dhe shkresat zyrtare për nevojat e tyre.

Krahas kësaj, ky vit për AZGJ-në ka qenë shumë i frytshëm edhe me aktivitete të tjera siç janë: konferenca shkencore, seminare, trajnimi i përkthyese dhe i lektorëve, botimi i studimit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019", nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit, pjesëmarrja në takime dhe konferenca për gjuhën shqipe dhe, në fund, përpilimi dhe publikimi i fjalorit terminologjik kontekstual interpretues VERBIS (www.verbis.gov.mk).



Pa dyshim, AZGJ-ja ka paraparë edhe shumë aktivitete të tjera gjatë vitit 2022, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin, kultivimin dhe mbrojtjen e gjuhës shqipe.

Duke e përmbyllur këtë vit, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së ju uron një vit të ri sa më të mbarë, me plot shëndet e mirëqenie!

REKOMANDIME

- Të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, t'i zbatojnë detyrimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Këto detyrime duhet të vlejnë edhe për ndërmarrjet private, qofshin ato të huaja apo të vendit.

- Realizimi i detyrimeve, para së gjithash, nënkuptohet ndërtimi i kapaciteteve të kuadrit dhe ato teknike në suazat e organeve (angazhimi i përkthyesve dhe lektorëve të kualifikuar, sigurimin e softuerit të përkthimit etj.) Të gjithë organet në aktin e tyre të sistematizimit dhe organizimit të brendshëm të vendeve të punës të, parashohë forma organizative/vende të punës për përkthyes dhe interpretues në dhe nga gjuha shqipe.

- Të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemit me mungesën e lektorëve të gjuhës shqipe, duke pasur parasysh se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ekziston institucion kompetent për realizimin e provimit për lektor të gjuhës shqipe dhe lëshimin e licencave për lektorë të gjuhës shqipe.

- Qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë, të krijojë politika nëpërmjet të cilave do të rritet atraktiviteti për regjistrim në katedrat e gjuhës dhe të letërsisë shqipe (drejtimi përkthim dhe interpretim) në institucionet publike të arsimit të lartë (për shembull, nëpërmjet rritjes së kuotave të regjistrimit, ndarjen e bursave të studimit dhe suksesit të arritur, punësimi i garantuar/stazhionimi me prioritet për punësim në sektorin publik etj.)

- Orvatjet e autoriteteve të drejtësisë të drejtohen nga ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve për përdorimin efektiv dhe efikas të gjuhëve në procedurat gjyqësore, administrative, procedurat e përmbarimit, procedurat e ekzekutimit të sanksioneve, procedurat hetimore dhe parahetimore, si edhe procedura të tjera para gjyqeve, prokuroritë publike, si edhe të gjithë organet e tjera të gjyqësisë, trupa dhe institucione.

- Ndërtimi i konceptit të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët medoemos duhet të ketë reflektim në arsim, duke filluar nga ai fillor,

nëpërmjet reformave të mësimit të gjuhës së bashkëqytetarit tënd, si mjet kryesor komunikimi, bashkëjetesë dhe kuptim i ndërsjellë.

- Të sigurohet respektim i tërësishëm i detyrimit ligjor të publikimeve në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" të ligjeve, akteve nënligjore, vendimet dhe shpalljet nga institucionet e pushtetit shtetëror, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj. Akoma nuk kemi respektim të tërësishëm të ligjit nga ky aspekt.

- Të gjithë institucionet kompetente t'i harmonizojnë aktet e veta të brendshme me dispozitat gjuhësore të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

- Institucionet që punojnë nëpërmjet sportelit/pultit, të sigurojnë që personat që punojnë në sportel/pult të kenë njohuri të të dy gjuhëve zyrtare. Vetëm kështu mund të arrihet dhe respektohet dygjuhësia institucionale.

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut t'i intensifikojë aktivitetet e ngritjes së vetëdijes publike, për zbatimin e vendimit ligjor të gjuhëve, si rregull pozitiv ligjor dhe t'i drejtojë aktivitetet e veta nga forcimi i konceptit qytetar të shoqërisë së barabartë për të gjithë qytetarët.

AZGJ-ja do të vazhdojë edhe më tutje me punën e saj të pandërprerë të jetë një faktor aktiv institucional në aspektin e zbatimit efikas dhe efektiv të kompetencave të veta në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve, njëherësh, një vazhdimësi, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e të drejtave gjuhësore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

rr. “Filipi i Dytë i Maqedonisë” nr. 11, kati i 3-të

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Ky raport është publikuar në mars të vitit 2022.

I disponueshëm është në maqedonisht, në shqip dhe në anglisht.